



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 14 regjistër (JR)
Datë 30.03.2021

Nr. 22 i vendimit
Datë 22.06.2022

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	Kryesues
Rezarta Schuetz	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 22.06.2022, në orën 14:00, ditën e mërkurë, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Francesco Ciardi, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 14/2021, datë 30.03.2021, që i përket:

ANKUES: Komisioneri Publik Darjel Sina.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 325, datë 14.12.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës; neni C, pika 2, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi në seancë gjyqësore publike, me praninë e palëve, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi Komisioneren Publike Irena Nino, e cila përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 325, datë 14.12.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, dëgjoi subjektin e rivlerësimit që kërkoi lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Në lidhje me rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të gjyqtares, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, i është nënshtruar *ex officio* procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

2. Më parë, në funksion dhe për zbatim të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor, deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional, në përputhje përkatësisht me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”). Konkretisht:

2.1 ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) një raport¹ të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se: (i) *deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin*; (ii) *nuk ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të justifikuar pasuritë*; (iii) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë*; (iv) *nuk ka kryer deklarim të rremë*; (v) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave*.

2.2 DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me qëllim që të identifikohet nëse ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin e datës 02.11.2017 për subjektin e rivlerësimit (deklasifikuar plotësisht me vendimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit nr. {***}, datë 04.10.2019), në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, duke konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi.

2.3 KLGj-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit, datë 02.04.2019.

3. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni e njohu subjektin e rivlerësimit me rezultatet e hetimit kryesisht për tri kriteret e vlerësimit – atë të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale – dhe i kaloi barrën e provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të sjellë shpjegime dhe prova për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit. Pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, në seancë dëgjimore publike, shqyrtoi pretendimet e parashtruara dhe provat e paraqitura prej saj, Komisioni mori vendimin

¹ Raporti i ILDKPKI-së nr. {***} prot., datë 12.06.2018.

objekt shqyrtimi, duke konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, me detyrë gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

II. Vendimi i Komisionit

Bazuar në nenin 59, pikat 1 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni vendosi konfirmimin në detyrë pasi konstatoi se subjekti i rivlerësimit (1) ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë; (2) ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës dhe (3) ka arritur një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

III. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik

4. Bazuar në nenin B, pika 3, shkronja “c” e Aneksit të Kushtetutës, tre përfaqësues të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (në vijim “ONM”), më datë 28.01.2021, kanë paraqitur pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë një “Rekomandim për paraqitje ankimi” ndaj vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit objekt shqyrtimi. Objekt i këtij rekomandimi janë rezultatet e hetimit administrativ për të tria kriteret e rivlerësimit. ONM-ja rekomandon që vendimi i Komisionit për znj. Selimi të rishikohet nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, pasi është e nevojshme të kryhet hetim dhe vlerësim i plotë, sipas standardeve ligjore dhe financiare të vendosura nga Kolegji mbi çështjet e ngritura në rekomandim. Mangësitë e parashtruara për të cilat duhet të hetohet sipas rekomandimit, përmblihen në vijim.

a. *Për kriterin e pasurisë*, rekomandimi parashtron se:

(i) *mungon* logjika ekonomike në sasinë e të ardhurave të përfituara nga kontratat e qirasë së njëjës prej pasurive në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit [pika e shitjes së karburantit, ndodhur në Vlorë];

(ii) *mungon* analiza e plotë e burimit të ligjshëm të investimit financiar të kryer nga vjehri i subjektit të rivlerësimit, z. K. S., i cilësuar si person tjetër i lidhur – referuar së njëjtës pasuri si më sipër;

(iii) *mungon* analiza për sa u përket burimeve të ligjshme të investimit të ndërtesës 3-katëshe në {***}, Fushë Krujë, në pronësi të vjehrit të subjektit të rivlerësimit;

(iv) hetimi lidhur me çmimin e blerjes së apartamentit në Tiranë, porositur nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti në vitin 2017, me shoqërinë “{***}” ShPK, është i *paplotë*;

(v) *mungon* hetimi lidhur me pasuritë e përdorura nga subjekti i rivlerësimit.

b. *Për kriterin e kontrollit të figurës*, rekomandimi parashtron se ekzistojnë rrethana dhe indicie të mjaftueshme që duhet të vlerësohen në raport me kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, në përputhje me nenin 38, pika 4, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

c. *Për kriterin e aftësive profesionale*, rekomandimi parashtron që:

(i) vlerësimi i subjektit se mungon detyrimi ligjor i tij për pagimin e taksave lidhur me të ardhurat e përfituara nga qiratë apo nga shitja e makinave, duhet të trajtohet në drejtim të vlerësimit etiko-profesional të subjektit të rivlerësimit;

(ii) për sa i përket vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të dhënë nga gjyqtarja A. G., në favor të subjektit të rivlerësimit në cilësinë e paditëses kundër shoqërisë “{***}” [nr. {***}], nëse mbahet në konsideratë pozicioni i subjektit të rivlerësimit si gjyqtare dhe një denoncim publik, Komisioni [dhe organet e rivlerësimit] duhet ta vlerësojnë kryekëput në drejtim të trajtimit

preferencial dhe të hulumtojnë nëse në pamje të parë jep përshtypjen e një vendimi të paarsyeshëm, i cili mund të potencojë një pabarazi përpara ligjit.

5. Komisioneri Publik Darjel Sina (në vijim “Komisioneri Publik”) ushtroi ankim ndaj vendimit objekt shqyrtimi të Komisionit, duke parashtruar se, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, ndan gjykim të kundërt nga Komisioni, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin në detyrë. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

a. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë

5.1.1 *Lidhur me pasurinë pikë shpërndarjeje e karburantit [me vendndodhje në Vlorë], përfundimi i Komisionit nuk është i mbështetur në një hetim të plotë në drejtim të dy burimeve të krijimit të pasurisë: (i) mundësisë së krijimit të të ardhurave të ligjshme të bashkëpronarit K. S., për pagesën në shumën 101.000 euro, kryer në datën 10.05.2013; dhe (ii) mundësisë së kursimit të shumës 10.000 euro, me të ardhura të ligjshme, nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, z. Sh. Selimi. Në funksion të një hetimi shterues administrativ, Kolegji mund të vlerësojë nëse ka rrethana që do të mund të ngarkonin me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit dhe të bënin të cenueshëm vendimin e Komisionit lidhur me këtë pasuri, në zbatim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016.*

5.1.2 *Lidhur me të ardhurat e përfituara nga dhënia me qira e së njëjës pasuri, situatat ligjore dhe faktike, parë në vlerësimin tërësor, mund të ngarkonin me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit dhe të bënin të cenueshëm vendimin e Komisionit, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, në zbatim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.*

5.1.3 *Lidhur me ndërtesën 3-katëshe, me vendndodhje në {***}, Fushë-Krujë, Kolegji do të vlerësonte drejt nëse, në vlerësim tërësor të procedurave, ngrihen dyshime në drejtim të interesave të fshehura të subjektit të rivlerësimit apo ndonjë paligjshmërie tjetër që do të mund të ngarkonte me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit dhe të bënte të cenueshëm vendimin e Komisionit, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.*

5.1.4 *Lidhur me apartamentin e ndodhur në {***}, Tiranë [me sip. 155 m² dhe 35 m² verandë], të porositur nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur në janar 2017, Komisioneri Publik pretendoi se, pas administrimit të akteve në funksion të një hetimi shterues administrativ, Kolegji mund të vlerësojë nëse ka rrethana që mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit dhe të bënin të cenueshëm vendimin e Komisionit lidhur me këtë pasuri, sipas përkufizimit të pasurisë të përcaktuar nga neni 3, pika 11 e ligjit nr. 84/2016, në zbatim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016.*

5.1.5 *Lidhur me automjetin në përdorim [markë “{***}” dhe me targë {***}], në pronësi të {***}, pas administrimit të akteve, në funksion të një hetimi shterues administrativ, Kolegji mund të vlerësojë nëse ka rrethana që do të mund të ngarkonin me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit dhe të bënin të cenueshëm vendimin e Komisionit, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.*

5.1.6 *Lidhur me automjetin tip “BMW 535 D” [me targë {***}] në përdorim, Kolegji mund të vlerësojë nëse ka rrethana që mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit dhe të bëjnë të cenueshëm vendimin e Komisionit, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.*

b. Për kriterin e kontrollit të figurës

5.2. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, Komisioni duhej të analizonte rrethanat ligjore që cilësojnë ekzistencën e një kontakti të papërshtatshëm në referim të nenit 38, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, në kushtet kur për personin e lidhur të subjektit, bashkëshortin [z. Sh. Selimi.], rezultoi i provuar kontakti i papërshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Në rastin konkret, dy vendime të institucioneve të rivlerësimit, si dhe një gjetje e ONM-së, janë rrethana dhe indicie të mjaftueshme që, për shkak të veçorive dhe burimit nga i cili janë marrë, të zhvillohet kontrolli i figurës.

c. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

5.3. Sa u përket çështjeve që lidhen me *detyrimet për pagimin e tatimeve*, Komisioneri Publik pretendon se (i) qiratë e përfituara apo (ii) të ardhurat nga shitja e makinave janë trajtuar nga Komisioni për qëllime të analizës financiare, ndërkohë që duket se ka edhe rrethana të tjera që lidhen me çështje etike dhe profesionalizmi, të cilat duhen analizuar jo vetëm në drejtim të efektit të mospagesës së këtij detyrimi tatimor në rezultatet e analizës financiare, por edhe në drejtim të vlerësimit etiko-profesional të subjektit të rivlerësimit.

5.3.1 Situatat ligjore dhe faktike mbi të cilat është mbështetur vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku subjekti i rivlerësimit është në cilësinë e paditëses kundër shoqërisë “{****}” [vendimi nr. {***}, datë 13.02.2017], në vlerësimin tërësor, në zbatim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, dhe në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, mund të çojnë në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit, parashtron Komisioneri Publik.

5.3.2 *Lidhur me ekzistencën e mundshme të gjendjes së konfliktit të interesit* në ushtrimin e detyrës, Komisioneri Publik pretendoi se përfundimet e Komisionit nuk janë bazuar në aktet në dosje, si dhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit, për sa i përket trajtimit të rasteve të ngjashme mbi identifikimin e konfliktit të interesit, sipas nenit 5 të ligjit nr. 9367/2005.

6. Në përfundim, Komisioneri Publik kërkoi që shkaqet e parashtruara në ankim, të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe, pasi të jetë kryer një hetim dhe vlerësim i plotë i rezultateve të hetimit për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur/të tjerë të lidhur me të, në zbatim të neneve 59 dhe 61 të ligjit nr. 84/2016, të vendosë në mënyrë alternative: (i) *ndryshimin e vendimit objekt shqyrtimi të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit*; ose (ii) *lënien në fuqi të këtij vendimi*.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

I. Aspektet procedurale të gjykimit

7. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”) ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve të parashikuara nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit

të rivlerësimit, duke e konfirmuar atë në detyrë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016. Meqenëse për vendimin objekt shqyrtimi ka ushtruar rekomandim ONM-ja, nën zbatim të rregullores për veprimtarinë e Kolegjit, ankimi i Komisionerit Publik në këtë çështje, shqyrtohet me përparësi².

8. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.
9. Në përputhje me nenin 65³, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, kur vendimi i Komisionit ankimohet nga Komisioneri Publik, ankimi shqyrtohet në seancë gjyqësore publike. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila ka për bazë ankimin e Komisionerit Publik ndaj vendimit të Komisionit nr. 325, datë 14.12.2020, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit në seancë gjyqësore publike, të zhvilluar në prani të palëve.

II. Procesi gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

10. Në seancën gjyqësore publike të zhvilluar në datën 28.04.2022, Komisioneri Publik u shpreh se u qëndronte të gjitha shkaqeve të ankimit, duke depozituar një analizë të shkaqeve të ankimit që përmbante riformulime të tyre. Në bisedimet përfundimtare, në seancën e datës 20.06.2022, Komisionerja Publike Irena Nino theksoi se shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe kriterin e vlerësimit të figurës, qëndrojnë. Për pasojë, nuk plotësohen kushtet e parashikuara në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Në një analizë të përmbledhur të provave të administruara nga Kolegji, Komisionerja Publike çmon se subjekti arriti të provojë se: (i) nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit sa i përket apartamentit në Tiranë (referuar në paragrafin 5.1.4 më sipër); (ii) nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit në ushtrimin e detyrës [shkaku i ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit profesional, referuar më sipër në paragrafin 5.3.1 dhe 5.3.2]. Komisionerja Publike u qëndroi shkaqeve të ankimit dhe kërkoi marrjen e tyre në konsideratë nga trupi gjykues, nën dritën e parashikimeve të nenit F, pikat 3 dhe 7 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 66 të ligjit nr. 84/2016.
11. Në seancën gjyqësore të datës 28.04.2022, subjekti i rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, parashitroi një kërkesë paraprake për pezullimin e shqyrtimit gjyqësor të ankimit të Komisionerit Publik në çështjen e rivlerësimit të saj, derisa të përfundojë hetimi pasuror që ka ndërmarrë Struktura e Posaçme Anti-Korrupsion (në vijim “SPAK”) për bashkëshortin e saj. Kjo kërkesë bazohet në parashikimet e nenit 297, shkronja “a”⁴ e Kodit të Procedurës Civile. Subjekti parashitroi se 10 ditë pasi është depozituar ankimi i Komisionerit Publik kundër vendimit objekt shqyrtimi, Prokuroria e Posaçme pranë SPAK-ut ka ndërmarrë hapa proceduralë si pasojë e të cilëve, më 15 prill 2021,

² Shih: https://kpa.al/wp-content/uploads/2021/10/Rregullore_Per_veprimtarine_e-KPA_me_ndryshimet_e_vendimit_nr_84_29-09-2021_per_web.pdf.

³ Procesi gjyqësor në Kolegjin e Apelimit kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48, pika 1; 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

⁴ “Gjykata vendos pezullimin e gjykimit kur: a) çështja nuk mund të zgjidhet para se të zgjidhet një çështje tjetër penale, civile ose administrative [...]”.

është regjistruar procedimi penal pasuror në ngarkim të bashkëshortit të subjektit [z. Sh. Selimi..] Subjekti parashtrioi po ashtu se objekt hetimi nga SPAK-u janë të dhënat e deklaratës *vetting* dhe deklaratimet periodike e, për pasojë, hetimi ka për objekt të njëjtat pasuri të cilat janë objekt shqyrtimi i procesit të rivlerësimit të subjektit.

11.1 Në përfundim, përveç kundërshtimeve për secilin shkak ankimi – të cilat shtjellohen në detaj më poshtë – subjekti i rivlerësimit kërkoi rrëzimin e ankimit të bërë nga Komisioneri Publik për ndryshimin e vendimit nr. 325, datë 14.12.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe lënien në fuqi të këtij vendimi.

11.2. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për pezullimin e procesit deri në një vendimmarrje nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, administroi dy aktet shkresore bashkëlidhur, në cilësinë e provave shkresore, dhe dëgjoi edhe Komisionerin Publik, vendosi ta rrëzonte atë kërkesë dhe vijoi shqyrtimin gjyqësor në seancë publike. Ky konkluzion i trupit gjykues mori në konsideratë një sërë faktesh të shtjelluara në vijim, për shkak të të cilave rezultoi se nuk ka vend zbatimi i nenit 297, germa “a” e Kodit të Procedurës Civile.

11.3. Procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë është një proces i një natyre të posaçme, i cili nuk mbivendoset dhe as konkurrin me procese të tjera. Leximi harmonik i dispozitave kushtetuese dhe atyre të ligjit nr. 84/2016 përcakton qartë që procesi i rivlerësimit ka natyrë disiplinore, është i pavarur dhe gjithëpërfshirës⁵ për subjektet e rivlerësimit që shprehin vullnetin për të qëndruar në organet e drejtësisë. Në mënyrë të veçantë, veçoria dhe autonomia e procesit të rivlerësimit del në pah në kontrast me procedimet penale nga organet e autorizuar në atë fushë, të cilat për shkak të natyrës së procesit penal – me fokus peshën potenciale të pasojave – ndjekin një trajektore e cila nuk mund të paragjykojë dhe as të ketë epërsi teorike mbi procesin e rivlerësimit, i cili është administrativ dhe disiplinor, me pasojat vetëm mbi të ardhmen profesionale të subjekteve. Është pikërisht kjo arsyeja përse ligjvënësi ka parashikuar që barra e provës në procesin e rivlerësimit u përket subjekteve të rivlerësimit, ashtu si edhe detyrimi për të shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurave, përcaktuar në mënyrë të shprehur si detyrime, ndër të tjera, në nenin Ç, pika 5 dhe në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, në lidhje me kontrollin e pasurisë.

11.4. Po ashtu, në procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, objekt shqyrtimi ishin të tria kriteret e rivlerësimit, përfshirë edhe kontrollin e figurës dhe kriterin e vlerësimit profesional. Si rrjedhojë, procedimi penal pranë SPAK-ut për personin e lidhur dhe procesi i rivlerësimit të vetë subjektit të rivlerësimit, mund të kishin mbivendosje teorike vetëm të pjesshme.

11.5. Për gjithë sa më sipër, trupi gjykues çmon se në rrethanat konkrete, nuk gjen zbatim neni 297, germa “a” e Kodit të Procedurës Civile, pasi procesi i rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit nuk kushtëzohet nga zgjidhja e çështjes penale nën procedim nga Prokuroria e Posaçme, qoftë në nivelin parimor, ashtu edhe në atë praktik. Nëse procesi i rivlerësimit për subjekte të ndryshme do të duhej të kushtëzohej nga procedimet civile, penale apo administrative, Kushtetuta dhe ligji do të kishin përcaktuar shprehimisht detyrat për institucionet e rivlerësimit dhe procedurat që do të duhej të ndiqeshin për të mundësuar eficiencën e procesit të rivlerësimit *vis a vis* pasojave teorike

⁵ Neni 179/b i Kushtetutës, me fokus pikat 3, 5, 6 dhe 7; neni D i Aneksit të Kushtetutës, me fokus pikat 1 deri në 4; neni E, pika 1 dhe neni F i Aneksit të Kushtetutës; neni 4, pikat 2 dhe 5 dhe neni 30 i ligjit nr. 84/2016, ndër të tjerë.

që rrjedhin nga kohëzgjatja e procedimeve të tjera të juridiksionit të zakonshëm gjyqësor. Në këto kushte, trupi gjykues vendosi të mos e pranojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit për pezullimin e gjykimit të kësaj çështjeje dhe ftoi palët të vazhdojnë me parashtrimet përkatëse.

12. Trupi gjykues i Kolegjit shqyrtoi shkaqet e pretenduara në ankim, duke i dhënë mundësinë subjektit të rivlerësimit të mbrohet dhe të japë shpjegime në lidhje me to. Në këtë drejtim, trupi gjykues dëgjoi palët dhe analizoi aktet e administruara në dosjen gjyqësore, të përbërë nga aktet e përcjella në Kolegji nga Komisioni, parashtrimet e depozituara nga palët gjatë seancave publike, provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit dhe të administruara⁶ në seancë gjyqësore me vendim të ndërmjetëm. Për këtë qëllim, trupi gjykues zhvilloi seanca gjyqësore publike në datat 28.04.2022, 19.05.2022, 06.05.2022 dhe 20.06.2022. Seanca për shpalljen e vendimit u zhvillua në datën 22.06.2022. Trupi gjykues vendosi ndryshimin e vendimit objekt shqyrtimi dhe shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, nga detyra pasi nuk arriti nivel të besueshëm në kontrollin e figurës dhe, për pasojë, ajo nuk gjendet në kushtet kumulative të përcaktuara nga neni 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Vlerësimi i trupit gjykues për secilin shkak ankimi shtjellohet në vijim.

III. Mbi themelin e pretendimeve sipas shkaqeve të ankimit të Komisionerit Publik dhe prapësimet e subjektit të rivlerësimit

A. Lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë

A.1. Pasuria pikë tregtimi karburanti me pakicë në Vlorë

13. Komisioneri Publik pretendon se përfundimi i Komisionit, lidhur me këtë pasuri, nuk mbështetet në një hetim të plotë e shterues të situatës faktike të krijimit të saj, sikurse edhe as në një vlerësim të kryer sipas standardit ligjor të Kolegjit. Këto problematika janë parë në drejtim të dy burimeve të krijimit të pasurisë në fjalë, e konkretisht: (i) mundësisë së krijimit të të ardhurave të ligjshme të bashkëpronarit K. S., për pagesën e datës 10.05.2013, në shumën 101.000 euro; dhe (ii) mundësisë së krijimit të të ardhurave të ligjshme për kursimin e shumës 10.000 euro nga subjekti i rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, dhe personi i lidhur [bashkëshorti] i saj. Konkretisht, për secilin nga këto aspekte, Komisioneri thekson që:

(i) Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk mbulojnë plotësisht me të ardhura të ligjshme shumën prej 10 mijë eurosh, të paguar në favor të bankës më 23.08.2013, në funksion të blerjes së pjesës takuese prej 50% të kësaj pasurie. Nga analiza e burimeve që janë deklaruar se

⁶ Aktet e sjella nga subjekti për të provuar prapësimet e saj përbëhen nga: (i) deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.12.2018; (ii) gjashtë (6) kontrata qiraje të pikës së tregtimit të karburantit me pakicë për periudhën 2014-2019; (iii) dy kontrata shitjeje pasurie të paluajtshme, shoqëruar nga kontratat e sipërmarrjes në vitet 2019-2021, që lidhen me apartamentin në Tiranë dhe një leje legalizimi për objektin e ndërtuar nga shoqëria "{***}" ShPK [përfshirë edhe Genplanin e objektit]; (iv) gjashtë shkresa nga gjykatat ku ka shërbyer subjekti i rivlerësimit, që datojnë mars-prill 2022, me anën e të cilave provohet që ajo nuk ka shqyrtuar çështje në kushtet e konfliktit të interesit me palë administratorin/ortakun e shoqërisë "{***}" ShPK; (v) dy fashikuj, përcjellë nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, në lidhje me çështjen me nr. {***} regjistri themeltar, datë 05.11.2014, dhe një fletë nga Regjistri Themeltar Civil i Gjykatës Administrative të Apelit, me nr. rendor {***}, datë regjistrimi 05.11.2014; (vi) dy shkresa të datave 05.04.2016 dhe 14.04.2026 të Gjykatës Administrative të Apelit, që përcaktojnë procedurën e rishortimit në atë gjykatë, si dhe një urdhër i datës 29.03.2016, i Kryetarit të së njëjtës gjykatë për të njëjtën lëndë dhe shkresë; (vii) urdhër i datës 21.03.2016, i Kryetarit të Gjykatës Administrative të Apelit që cakton gjyqtarët e së njëjtës gjykatë në trupa gjykues; (viii) certifikatë e sigurimit të personelit, lëshuar për subjektin e rivlerësimit më datë 09.11.2021.

kanë shërbyer për të gjeneruar këtë shumë, në përlllogaritjen e Komisionerit Publik, nuk rezultojn se mbulohet plotësisht me burime të ligjshme blerja e një automjeti në vitin 2011, shitja e të cilit ka gjeneruar të ardhurat për pagesën, por nga ana tjetër, nuk janë paguar detyrimet tatimore që rrjedhin nga shitja e të njëjtit automjet në vitin 2012.

(ii) Z. K. S. është *person tjetër i lidhur* me subjektin e rivlerësimit, nën dritën e përcaktimeve të nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, mbi bazën e lidhjes së interesit e cila është krijuar për shkak të 7 (shtatë) elementeve, e konkretisht: (i) bashkinvestimit në pasurinë objekt analize në vitin 2013; (ii) huaja në shumën 5.140 euro, dhënë nga personi i lidhur [bashkëshorti i subjektit], z. K. S., deklaruar e shlyer në DIPP-në e vitit 2014; (iii) huaja në shumën prej 42.500 eurosh, e dhënë nga personi i lidhur [bashkëshorti i subjektit], z. K. S., e deklaruar në DIPP-në e vitit 2017; (iv) vendosja e apartamentit në Krujë, nga z. K. S., si kolateral për kredinë bankare të përfituar nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur në vitin 2008; (v) fakti që z. K. S. paraqitet në cilësinë e bashkëdebitorit në kontratën e huas së vitit 2013 [me Tirana Bank], marrë për blerjen e pasurisë objekt analize (në këtë kontratë, pasuria në bashkëpronësi u vendos si kolateral për huan); (vi) personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit dhe i ati kanë dhënë me qira pasurinë në fjalë dhe të ardhurat e gjeneruara janë depozituar në llogarinë e tyre të përbashkët; (vii) subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar z. K. S. si person të lidhur në deklaratën *vetting*, në seksionin përkatës.

13.1. Komisioni ka konkluduar që “familja e subjektit të rivlerësimit” ka pasur balancë negative prej 179.325 lekësh në vitin 2013, për të kryer pagesat për pjesën takuese prej 50% të bashkëpronësisë, si dhe për shpenzimet e tjera. Së dyti, ndonëse ka konstatuar se z. K. S. nuk është person tjetër i lidhur nën dritën e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, meqenëse nuk paraqitet në cilësinë e huadhënësit apo dhuruesit, Komisioni gjithsesi e ka cilësuar këtë individ *person tjetër të lidhur*, në funksion të analizës së kësaj pasurie, për shkak të “marrëdhënies së ngushtë familjare, edhe mbi pasuri të mundshme të fshehura të subjektit të rivlerësimit”, si dhe në kushtet e bashkëpronësisë për këtë pasuri⁷. Si rrjedhojë, Komisioni ka kryer edhe një përlllogaritje të të ardhurave të z. K. S., nga e cila ka rezultuar *mjaftueshmëri* financiare me burime të ligjshme për të mbuluar 50% të vlerës së investuar prej tij në këtë pasuri⁸.

13.2 Në parashtrimet e saj në Kolegj, subjekti i rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, kundërshtoi arsyetimin e Komisionerit, duke theksuar se balanca negative për pjesën takuese është derivat i një përlllogaritjeje teorike të të ardhurave dhe shpenzimeve, të cilat ajo dhe personi i lidhur i kanë deklaruar rregullisht dhe i mospërfshirjes së të ardhurave të përfituara nga shitja e një automjeti, sipas një analize të detyrimeve tatimore, që bazohet në një interpretim të gabuar të ligjit nr. 8438/1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”. Subjekti, po ashtu, argumentoi se z. K. S. nuk mund të cilësohet si person tjetër i lidhur në kuptimin e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

13.3. Në analizë të pretendimeve të Komisionerit Publik, akteve në fashikull, konkluzioneve të Komisionit dhe pretendimeve e shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim dhe nga analiza financiare e kryer në Kolegj, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur rezultojnë me një balancë negative prej 176.227 lekësh për krijimin e kësaj pasurie dhe përbalimin e shpenzimeve. Nga ana tjetër, trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje se leximi harmonik i dispozitave ligjore, zbatuar në rrethanat faktike konkrete, tregon se z. K. S., pavarësisht nga cilësia e ndërmarrë si bashkinvestitor me

⁷ Shih arsyetimin e shtjelluar në paragrafin 110, faqe 27 e vendimit objekt shqyrtimi të Komisionit në: <https://kpk.al/wp-content/uploads/2021/01/Vendim-Rilinda-Selimi.pdf>.

⁸ Paragrafi 113, faqe 28 e vendimit të Komisionit të sipërcituar.

personin e lidhur me subjektin, nuk përmbush kushtet për t'u cilësuar si person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit. Z. K. S. nuk rezulton të ketë qenë dhurues apo huadhënës në krijimin e kësaj pasurie, nën dritën e nenit 32, pika 4 e ligjit⁹. Për të njëjtat arsye, pretendimi i Komisionerit Publik se ka elemente mbi bazën e të cilave duhet të gjejë zbatim neni 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016 mbi bazën e marrëdhënies së interesit, nuk gjendet i bazuar. Ky konkluzion mbështetet edhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit, sikurse edhe në faktet që shtjellohen në vijim, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim.

13.4. Nga aktet në fashikull, rezulton se në deklaratën *vetting*, subjekti e ka deklaruar këtë pasuri në bashkëpronësi dhe me të dhënat përkatëse: “me sipërfaqe trualli 432 m² dhe ndërtim 135,25 m², blerë datë 10.05.2013 [...] Vlera 250.000 euro [...]”. Subjekti i rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, ka deklaruar pagesën prej 125.000 eurosh prej saj dhe bashkëshortit, si bashkëpronarë të ½ pjesë. Burimet financiare të deklaruara prej saj janë specifikuar: “të ardhurat e krijuara ndër vite nga: (i) vlera 69.560 euro, nga kontrata e shitjes së apartamentit në lagjen “{***}”, Vlorë; (ii) vlera 9.500 euro, nga kontratat e shitjes së garazhit në lagjen “{***}”, Vlorë; (iii) kursimet nga pagat [...] 2.000 euro, dhe vlera e shitjes së automjetit “Mercedes Benz”, 8.000 euro, të depozituara në bankën Intesa SanPaolo; (iv) vlera 10.000 euro, në bankën Credins, kursime nga pagat [...]; (v) shuma 6.600.000 lekë hua nga Tirana Bank, [...] dorëzanës bashkëpronari tjetër K. S.. Pjesa takuese 50% e të gjithë pasurisë, pjesë takuese e imja dhe e bashkëshortit”. Në Deklaratën e Interesave Privatë Periodike (në vijim “DIPP”) të vitit 2013, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të njëjtën pasuri dhe pjesë takuese.

13.5. Së pari, për sa i përket shkakut të ankimit që lidhet me burimin e ligjshëm të krijimit të shumës 10.000 euro nga të ardhurat e shitjes së automjetit, të cilat kanë shërbyer për të krijuar depozitën në Intesa San Paolo Bank, që më pas kanë shërbyer kundrejt blerjes së pasurisë objekt i kësaj analize, edhe nga analiza financiare e kryer në Kolegji, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk kishte mundësi të blinte automjetin tip Mercedes Benz dhe të përballonte shpenzimet për vitin 2011, për vlerën 118.263 lekë. Për vitin 2012, rezultoi se diferenca mes të ardhurave dhe shpenzimeve është pozitive. Ndërsa, për vitin 2013, nga analiza financiare rezulton se subjekti i rivlerësimit ndodhet në pamundësi për të krijuar pasurinë dhe për të përballuar shpenzimet në vlerën -176.227 lekë. Në këto kushte, subjekti rezulton me një mungesë burimesh të ligjshme në kuptim të parashikimeve të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

13.6 Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit, që marrëdhënia e personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit me të atin, z. K. S., nuk përmbush kushtet e përcaktuara në ligj për t'i atribuar këtij të fundit cilësinë e personit tjetër të lidhur me subjektin, bazohet në një analizë rigorozë të dispozitave ligjore në fuqi. Dispozitat në fjalë, konkretisht, neni 3, pika 14 dhe neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, parashikojnë shprehimisht sa vijon:

[...] “Persona të tjerë të lidhur” janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin ose komisionerin publik që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi [...].

⁹ Neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 përcakton: “[...] 4. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive [...]”.

[...] Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive [...].

13.7 Nën dritën e dispozitave ligjore që rregullojnë konceptin e personit tjetër të lidhur dhe duke pasur në konsideratë që shtrirja e kontrollit mbi gjithë pasuritë e personave që kanë marrëdhënie interesi do të përbënte një barrë disproporcionale dhe të pamundur për subjektet e rivlerësimit¹⁰, ashtu siç është interpretuar gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit për premiset në të cilat gjen zbatim neni 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues i Kolegjit vëren se z. K. S. nuk mund të konsiderohet person tjetër i lidhur. Ky vlerësim gjen zbatim edhe nëse analizohen veçmas e së bashku 7 (shtatë) aspektet e marrëdhënies mes bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe të atit, që janë sjellë në vëmendje nga Komisioneri Publik. Kjo marrëdhënie nuk përmbush kriteret e përcaktuara nga ligji nr. 84/2016 për konceptin e personave të tjerë të lidhur, sikurse edhe tejkalon qëllimin e procesit të rivlerësimit sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës, i cili përfshin pasuritë në pronësi apo përdorim të subjekteve të rivlerësimit¹¹ e personave të lidhur me ta. Cilësia e bashkinvestitorit dhe bashkëpronësia nuk mund të passjellë automatikisht detyrimin e subjektit të rivlerësimit për të provuar ligjshmërinë e burimeve në kuadër të procesit të rivlerësimit. Në të kundërtën, një detyrim i tillë do të përbënte një barrë ekseseive për subjektet e rivlerësimit apo personat e lidhur me ta.

13.8 Përpos sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se ankimi i Komisionerit Publik¹², sikurse edhe hetimi i kryer nga Komisioni, nuk rezultojnë të kenë pasur për objekt dyshimin për pasuri të fshehur nga subjekti [dhe personi i lidhur] në emër të z. K. S.. Nga aktet në fashikull, nuk rezultojnë që subjektit të rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, t'i ketë kaluar barrë prove për fshehje të interesave të saj pasurorë në asnjë prej pasurive të kontrolluara, përfshirë edhe këtë pasuri, gjatë hetimit administrativ. Barra e provës për balancën negative të vitit 2013 [viti i blerjes së pasurisë] ka pasur për objekt vlerën e sipërcituar¹³, ndërsa analiza financiare e kryer për mundësinë e z. K. S. ka rezultuar me balancë pozitive për pjesën takuese. Në këto rrethana procedurale, trupi gjykues e gjeti të pabazuar dhe të pamundur të hetonte në drejtim të cilësimit të z. K. S. si person tjetër i lidhur, në zbatim të orientimit të dhënë nga Kolegji, ndër të tjera në vendimin që i përket subjektit të rivlerësimit D. Rreshka [JR 37/2018].

13.9 Lidhur me marrëdhënien e konfirmuar të huadhënies – konkretisht, huaja në vlerën 5.140 euro, dhënë z. K. S. nga personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, formalizuar me deklaratën noteriale të datës 16.03.2015 – trupi gjykues i Kolegjit vëren se kjo marrëdhënie përbën një interes pasuror, por duke pasur parasysh kahun në të cilin shkon kontributi, nuk mund të argumentohet se

¹⁰ Shtjelluar në vendimin e Kolegjit që i përket subjektit të rivlerësimit D. Rreshka [JR nr. 37/2018], paragrafët 109 dhe 110, ndër të tjera sikurse edhe në vendimin që i përket subjektit të rivlerësimit I. Balli [JR nr. 31/2019].

¹¹ Neni D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës që përcakton qëllimin e deklaramit dhe kontrollit të pasurisë në procesin e rivlerësimit.

¹² Për herë të parë, Komisioneri Publik parashtroi për shqyrtim alternativën e një pasurie të fshehur nga subjekti dhe personi i lidhur në formën e bashkëpronësisë në mënyrë të shprehur vetëm në parashtrimet në seancën publike të datës 28.04.2022. Shih faqen 4 të parashtrimeve në: <http://ikp.al/wp-content/uploads/2021/02/Parashtrimet-e-%C3%A7%C3%ABshtjes-dar%C3%AB-28.4.2022.pdf>.

¹³ Për shpenzimet në vitin 2013, në vlerën 179.325 lekë, sipërcituar në paragrafin 13.1, referuar edhe rezultateve të hetimit kryer nga Komisioni, dërguar subjektit më 27.11.2020.

krijon premiset për cilësimin e huamarrësit person tjetër i lidhur, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Në funksion të procesit të rivlerësimit, kjo marrëdhënie u analizua në Kolegj në drejtim të mundësisë së krijimit të fondeve për të përballuar huan me burime të ligjshme. Analiza financiare e vitit 2014 për subjektin e rivlerësimit dhe personin e lidhur rezultoi me *mundësi* për krijimin e këtyre të ardhurave dhe përballimin e shpenzimeve të dokumentuara e deklaruar¹⁴. Në këto kushte, duke përjashtuar mungesën e burimeve të ligjshme si problematikë, ky aspekt i kontrollit të pasurisë së subjektit u konsiderua i shteruar nga trupi gjykues i Kolegjit. Në këtë konkluzion, trupi gjykues mbajti në konsideratë edhe specifikimet në deklaratën noteriale të lëshuar nga z. K. S. për huan dhe kohën kur ajo është kryer përkundër procesit të rivlerësimit – mars 2015 – kohë përpara rivlerësimit – si dhe faktin që huaja ka lënë gjurmë të pakontestueshme në transaksionet bankare që provojnë sa pretendohet në këtë deklaratë¹⁵, sikurse edhe në deklaratën periodike vjetore të subjektit të rivlerësimit për vitin 2014.

13.10 Ky arsyetim – lidhur me mospërmbushjen e kushteve përcaktuese për cilësimin e z. K. S. person tjetër të lidhur – gjen zbatim edhe në lidhje me huan e dytë nga personi i lidhur me subjektin, në favor të z. K. S., deklaruar në deklaratën periodike vjetore për vitin 2017, në shumën 42.500 euro. Sa i përket çështjes së ligjshmërisë së burimeve për huan e dhënë, trupi gjykues i Kolegjit vëren së pari se: (i) nga analiza e kryer gjatë hetimit administrativ në Komision, nuk janë konstatuar probleme mungesash të burimeve financiare¹⁶; (ii) ky element nuk i është nënshtruar kontrollit nga ana e Kolegjit, pasi nuk ka përbërë shkak ankimi; dhe (iii) i është nënshtruar hetimit nga Komisioni në funksion të një pasurie tjetër, duke qenë përtej harkut kohor të rivlerësimit që ka për prag të fundit, datën e plotësimit të deklaratës *vetting* nga subjekti i rivlerësimit.

13.11 Komisioneri Publik argumenton për kategorizimin e z. K. S. si person tjetër i lidhur me subjektin edhe për shkak të vendosjes së apartamentit në pronësi të tij dhe bashkëshortes si kolateral kundrejt një huaje të marrë nga subjekti dhe personi i lidhur. Nga aktet në fashikull¹⁷, rezulton se z. K. S., nëpërmjet dorëzansisë, ka vënë në dispozicion të gjithë pasurinë e tij për të garantuar përmbushjen e detyrimit të kredimarrësit (subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti), dhe nëpërmjet hipotekës ka vënë si mjet garancie një pasuri konkrete të individualizuar në kontratën e

¹⁴ Nga analiza e kryer në Komision, balanca e fundvitit 2014 rezulton në vlerën (pozitive) prej 193.439 lekësh, ndërsa në Kolegj kjo balancë rezultoi në vlerën 192.462 lekë.

¹⁵ Konkretisht, në deklaratën noteriale të datës 16.03.2015 [nr. rep. {***} dhe nr. {***} kol.], z. K. S. ka deklaruar se i detyrohej të birit, SH. Selimi, për shumën në vitin 2014, të cilat ai (i biri) i kishte paguar (më shumë) nga të ardhurat e tij “për shlyerjen e kredisë”. Në funksion të shlyerjes së këtij detyrimi, ai shprehet se ka derdhur në llogarinë e të birit 90.000 lekë në muajin nëntor 2014, ndërsa pjesa që mbetet [4.500 euro] është kompensuar përmes shumës së paguar nga qiradhënësi [{"***"} ShPK]. Nga konfirmat bankare të administruara gjatë hetimit administrativ, konfirmohet përfitimi në llogarinë bankare të personit të lidhur me subjektin në Tirana Bank, në datën 03.11.2014, nga z. K. S., me përshkrimin “K. S. {***} këst kredie”, në vlerën 90.000 lekë. Po ashtu, në datën 09.12.2014, llogaria në euro e personit të lidhur të subjektit të rivlerësimit, është kredituar nga shoqëria [{"***"} ShPK, me përshkrimin “Nga {***} ShPK likuidim qira dhjetor 14, -10% tatim në burim”, në vlerën 9000 euro. Në të njëjtën datë, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit e ka kaluar shumën 9.000 euro në depozitë me përshkrimin “To S. Sh. acc ½ qira + detyrim nga bashkëpronari K. S.”.

¹⁶ Sipas vendimit, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur rezultojnë me balancë pozitive prej 899.403 lekësh në vitin 2017 – shih faqen 26 të vendimit objekt shqyrtimi të Komisionit.

¹⁷ Kontrata e datës 14.04.2008, me nr. {***}rep., dhe {***} kol. Kredia në shumën prej 20.000 eurosh është marrë nga NBG Bank, për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 98 m², nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur në vitin 2008 [14.04.2008], me afat shlyerje 5 vjet. Në funksion të kësaj kredie, z. K. S. ka cilësinë e dorëzansisë, si dhe ka hipotekuar një apartament me sipërfaqe 57,10 m², në pronësi të tij dhe të bashkëshortes. Nga dokumentacioni, rezulton që hipoteka dhe dorëzania janë shuar me shlyerjen e detyrimit të kredisë më datë 05.05.2013.

kredisë – apartamentin e tij. Marrëdhëniet juridike të dorëzarisë dhe të hipotekës, ndonëse përfaqësojnë interesa pasurore, nuk janë parashikuar si marrëdhënie për të cilat subjektet e rivlerësimit mbajnë detyrimin për të provuar burimet e ligjshme sipas nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, sikurse shtjellohet më sipër lidhur me pikën e tregtimit të karburantit me pakicë, parë nën dritën e mungesës së kushteve procedurale për të shqyrtuar për pasuri të fshehur të vetë subjektit të rivlerësimit, zbatimi i përkufizimit të nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016 për ta konsideruar z. K. S. – e për pasojë, kontrollin e gjithë pasurive të tij – do të ishte në tejkalim të mundësive dhe kufizimeve që përcakton ligji në funksion të rivlerësimit kalimtar.

13.12 Lidhur me kontratën e huas së marrë bashkërisht në vitin 2013, nga z. K. S. dhe personi i lidhur me subjektin, me qëllim blerjen e pikës së karburantit në Vlorë, si bashkëpronarë, trupi gjykues sjell në vëmendje arsyetimin e kryer në hyrje të kësaj rubrike e që lidhet me bashkinvestitorët. Në funksion të procesit të rivlerësimit, pa përsëritur sa është shtjelluar në detaj në paragrafin 13.7, bashkëpronarët e subjekteve të rivlerësimit, të cilët në varësi të rrethanave të ndryshme, mund të paraqiten edhe si bashkëdebitorë, ndonëse në marrëdhënie interesi, nuk bëjnë pjesë në rrethin e personave të lidhur sipas nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për sa kohë – në vijim të jurisprudencës së Kolegjit – nuk është në dyshim një pronë e fshehur e subjektit të rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, në emër të vjehrrit të saj, nuk gjen zbatim koncepti i personit tjetër të lidhur për shkak të marrëdhënies së interesit.

13.13 Në të njëjtën linjë arsyetimi dhe në vijim të sa më sipër, edhe dhënia me qira e pasurisë nga bashkëpronarët – sikurse edhe veprime të tjera juridike të ligjshme – nuk mund të argumentohet se përbën marrëdhënien e interesit, e cila do të duhet të përkthehet në përgjegjësi për subjektin e rivlerësimit për të justifikuar burimet e ligjshme të krijimit të pasurisë së bashkëpronarëve. Nga ana tjetër, fakti që të ardhurat e gjeneruara nga qiradhënia janë depozituar në llogarinë e përbashkët të bashkëpronarëve, nën dritën e faktit që llogaria e përbashkët përfiton derdhje të cilat janë nga aktiviteti i biznesit, në vlerësimin e trupit gjykues, përbën një derivat të mënyrës së zgjedhur për të ruajtur të ardhurat nga bashkëpronarët, për sa kohë nuk përmbushen kriteret e tjera – kërkesa procedurale dhe hetim për fshehje të pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur në kuadër të procesit të rivlerësimit.

13.14 Së fundmi, sipas Komisionerit Publik, fakti që subjekti i rivlerësimit ka deklaruar z. K. S. si person të lidhur në deklaratën *vetting*, dëshmon nevojën për këtë cilësim në funksion të kontrollit të vendimit objekt shqyrtimi të Komisionit. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se në faqen 14 të deklaratës së pasurisë, në rubrikën që kërkon deklarimin e personave të besuar dhe të lidhur¹⁸, subjekti i rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, ka deklaruar tre persona: z. K. S. – në cilësinë e bashkëpronarit me personin e lidhur dhe cilësuar “vjehri i deklarueses”, një qiramarrës – person juridik për pasurinë pikë tregtimi karburanti – dhe një individ, qiradhënëse, pronare e apartamentit ku subjekti jetonte me qira në Tiranë. Me fjalë të tjera, në rubrikën që kërkon renditjen e personave të lidhur, subjekti ka deklaruar personat me të cilët ajo ka marrëdhënie juridike interesi. Në analizë të këtyre deklarimeve, trupi gjykues vlerëson se përfshirja e këtyre personave në rubrikën në fjalë, tregon një mënyrë të kuptuari të subjektit, sipas së cilës ajo ka zgjedhur të deklarojë të gjitha marrëdhëniet e interesit, qoftë ato të cilat gjenerojnë të ardhura, qoftë ato për të cilat mbart detyrime financiare – siç është banimi në apartament kundrejt qirasë. Pa përsëritur sa është shtjelluar më sipër, edhe ky argument gjendet nga trupi gjykues i pamjaftueshëm për të cilësuar z.

¹⁸ “Të dhëna për persona fizikë e juridikë, duke përfshirë edhe personin e besuar, që rezultojnë të lidhur me subjektin e rivlerësimit që mbart detyrimin për deklarim” – shtojca nr. 2, ligji nr. 84/2016.

K. S. si person tjetër të lidhur. Në të kundërtën, nëse do të merrej si premisë specifikimi i subjektit në faqen 14 të deklaratës së pasurisë, kontrollit të pasurisë do t'i nënshtroheshin edhe qiradhënësit apo qiramarrësit, marrëdhënie të cilat haptazi kapërcejnë qëllimin e procesit të rivlerësimit, sipas dispozitave të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit.

13.15 Në përmbledhje të sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se në kushtet dhe rrethanat e analizuarra më sipër, z. K. S. nuk përbën person tjetër të lidhur sipas përcaktimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Rrethanat faktike e procedurale të çështjes objekt kontrolli nuk mbështesin zbatimin e përcaktimit të kësaj cilësie mbi bazën e interesave pasurore. Për këtë arsye, ky pretendim i Komisionerit Publik u gjet i pabazuar në ligj dhe në fakte. Të gjendur në kushtet e mungesës së provueshmërisë së dyshimeve për fshehje të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit çmoi se verifikimi i mëtejshëm i pasurive në emër të z. K. S. do të përbente kapërcim të objektit të procesit të rivlerësimit. Për këto arsye, në vijim edhe të jurisprudencës së sipërcituar në paragrafët 13.7 dhe 13.8, trupi gjykues i Kolegjit, me vendim të ndërmjetëm, konsideroi të panevojshme të hetohet më tej për burimin e krijimit të gjysmës së pasurisë që i përket babait të subjektit të rivlerësimit.

A.2. Të ardhurat e përfituara nga dhënia me qira e pikës së tregimit të karburantit në Vlorë

- 14.** Komisioneri Publik pretendon se kontrata e lidhur nga bashkëpronarët [personi i lidhur dhe i ati, z. K. S.] me shoqërinë “{***}” ShPK, nuk ka elementet tipike të kontratës së qirasë, pavarësisht se është cilësuar nga palët si kontratë qiraje. Sipas Komisionerit Publik, ajo është një marrëveshje *sui generis*. Pagesa e përmuajshme jo domosdoshmërisht e kanalizon marrëdhënien te kontrata e qirasë. Komisioneri Publik çmon se këto situata ligjore dhe faktike, parë në vlerësimin tërësor, mund të ngarkonin me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit dhe të bënë të cenueshëm vendimin e Komisionit, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, në zbatim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Komisioneri Publik argumentoi po ashtu, se subjekti i rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, dhe personi i lidhur [bashkëshorti i saj], e kanë ekspozuar veten ndaj rrezikut që pala tjetër t'i imponojë një fitim më të madh ose më të vogël, që sjell si pasojë ekspozimin e subjektit ndaj rrezikut që të jetë nën ndikimin e palës tjetër, edhe në përmbushjen e detyrave publike. Komisioneri solli në vëmendje për këtë qëllim jurisprudencën e Kolegjit në çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit Besnik Cani [vendimi (JR) nr. 2/2020], ku marrëdhënie të tilla kontraktuale janë arsyetuar të prodhojnë një mospërputhje thelbësore me funksionin e magjistratit dhe detyrimet në lidhje me etikën. Komisioneri Publik vlerësoi se këto situata ligjore mund të analizohen në drejtim të cenimit të besimit të publikut për subjektin e rivlerësimit, pasi paraqesin natyrë atipike.

14.1 Në parashtrimet e saj në Kolegj, subjekti i rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, kundërshtoi pretendimet e Komisionerit Publik, duke argumentuar që pretendimi se kontrata e qirasë nuk ka elementet tipike, bie ndesh me faktin që çmimi i qirasë ka qenë i përcaktueshëm, në formë monetare dhe periodike mujore. Bashkëpronarët Sh. dhe K. S. nuk kanë pasur asnjëherë cilësi të ngjashme me atë të investitorit, me natyrë përfitimi tregtar. Me të drejta dhe detyrime që përkojnë me raportin përkatës të bashkëpronësisë, ata kanë dhënë pronën në fjalë me qira kundrejt shpërblimit, në përputhje me rregullimet që bënë Kodi Civil për kushtet, të drejtat dhe detyrimet e kontratës së qirasë. Së fundmi, subjekti i rivlerësimit kundërshtoi arsyetimin e parashtruar nga Komisioneri në drejtim të cenimit të besimit të publikut tek ajo si magjistrate, nisur nga dhe mbi bazën e marrëdhënies që, sipas Komisionerit, nuk përbën qira tipike. Subjekti i rivlerësimit, znj.

Rilinda Selimi, solli shtatë (7) kontrata noteriale qiraje në cilësinë e provës¹⁹, për të kundërshtuar pretendimin e Komisionerit Publik për vlera të larta të qirasë, duke argumentuar që marrëdhëniet e qirasë të pasqyruara në aktet e sjella prej saj e që u përkasin palëve të tjera kontraktore, subjekte të përfshira në tregtimin e karburanteve në qytetin e Vlorës, provojnë se çmimi i qirasë është në vlera të ngjashme e më të larta se ato të përfituara nga bashkëpronarët Sh. Selimi. dhe K. S.. Të gjitha këto akte u administruan nga trupi gjykues në cilësinë e provës dhe janë pjesë e analizës në vijim.

14.2 Komisioni ka hetuar në lidhje me të ardhurat nga qiradhënia e kësaj pasurie në funksion të saktësisë së deklaramit të tyre dhe në drejtim të gjenerimit të burimeve për të shlyer pagesat e detyrimeve për kredinë e marrë për blerjen e kësaj pasurie. Pavarësisht se Komisioni duket se ka sjellë në vëmendje ndryshimin mes vlerës së qirasë së paguar nga dy subjekte tregtare [***]ShPK dhe [***]ShPK] krahasuar me “{***}” dhe “{***}”, në konkluzion, është përmendur vetëm qarkullimi i konsiderueshëm financiar i kompanive në fjalë. Nga ana tjetër, në vendim nuk rezulton një analizë në drejtim të natyrës së kontratave, apo çmimit të tyre krahasuar me tregun apo me aktivitetet tregtare të tjera, të ngjashme, në funksion të logjikës ekonomike apo se si këto marrëdhënie mund të ndikojnë mbi rivlerësimin e subjektit.

14.3 Pasi analizoi pretendimet e Komisionerit Publik, prapësimet e subjektit të rivlerësimit dhe aktet në fashikull, në zbatim të dispozitave kushtetuese e ligjore, trupi gjykues i Kolegjit vëren se kontratat e qirasë të lidhura mes disa operatorëve ekonomikë – persona juridikë të përfshirë në tregtimin e karburanteve – dhe personit të lidhur me subjektin dhe bashkëpronarin, tregojnë se pretendimet e subjektit të rivlerësimit janë bindëse. Marrëdhënia e lidhur mes palëve për qiranë e objektit, analizuar brenda gamës së hetimit në funksion të procesit të rivlerësimit, nuk mund të argumentohet se përmbush kushtet që të cenojë besimin e publikut te subjekti i rivlerësimit. Ky vlerësim i trupit gjykues u bazua në një analizë në harmoni të dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, të akteve të sjella nga subjekti dhe të administruara në Kolegj në cilësinë e provës, dhe merr në konsideratë edhe jurisprudencën e mëparshme të Kolegjit, sjellë në vëmendje nga Komisioneri.

14.4 Së pari, trupi gjykues vëren se nga analiza e kontratës që përbën bazën e shkakut të ankimit, marrëdhënia e krijuar mes palëve nuk identifikon elemente që karakterizojnë një shoqëri tregtare²⁰, e për pasojë të përjashtojë mundësinë e marrëdhënies së qirasë. Së dyti, nga aktet e sjella nga subjekti në cilësinë e provës, krahasuar me çmimet e kontratave në vijim²¹, çmimet e vendosura

¹⁹ Konkretisht, subjekti solli në cilësinë e provës gjashtë (6) kontrata qiraje të lidhura në periudhën kohore nga viti 2013 deri në vitin 2021, për pika tregtimi karburanti në Tiranë dhe Vlorë, me kohëzgjatje nga 5 deri në 7 vjet dhe me çmime që variojnë nga 700 mijë dhe 1 milion lekë, në 11 mijë euro apo 13 mijë dollarë amerikanë. Po ashtu, subjekti përçolli edhe një kontratë noteriale qiraje mes personit të lidhur dhe shoqërisë “{***}” ShPK, të datës 26.12.2018, me çmim qiraje 4700 euro në muaj.

²⁰Neni 1074 i Kodit Civil, “Shoqëria e thjeshtë”: “Shoqëria është një kontratë me të cilën dy apo më shumë persona merren vesh për të ushtruar një aktivitet ekonomik, me qëllim që të ndajnë fitimet që rrjedhin prej tij. Personi anëtar i shoqërisë duhet të vërë në dispozicion të këtij aktiviteti para, sende apo shërbime”.

²¹ Kontratë noteriale qiraje e datës 01.10.2014 [nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol.] me shoqërinë “{***}” ShPK, nga 01.10.2014 deri 01.10.2024. Qiraja e përcaktuar nga palët është në vlerën fikse 10.000 euro në muaj. Sipas akteve të administruara në dosjen e Komisionit, qiramarrësi ka kaluar në llogarinë bankare të qiradhënësve vlerën 9.000 euro si qira mujore pasi ka zbritur vlerën 10% të tatimit në burim të qirasë. Kjo kontratë është revokuar [me akt noterial me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., të datës 27.05.2015], shtatë (7) muaj pas lidhjes së kontratës së qirasë. Më datë

mes palëve nuk rezultojnë të pazakonta, inkonsistente apo që të favorizojnë personin e lidhur me subjektin. Bashkëpronarët K. dhe Sh. Selimi. (respektivisht vjehri dhe bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit) kanë disponuar me dy kontrata noteriale për të dhënë me qira pikën e karburantit në Vlorë, në datën 26.07.2013, me shoqërinë “{***}” ShPK dhe shoqërinë “{***}” ShA, me kohëzgjatje 2-vjeçare. Sipas kësaj kontrate, qiramarrësi detyrohet t’i paguajë qiradhënësit një qira mujore të përlllogaritur në bazë të fitimit mujor, respektivisht duke përfutur: 90% qiradhënësi dhe 10% qiramarrësi²². Trupi gjykues vëren se, pavarësisht se qiraja në pamje të parë duket e lartë, në mungesë të informacionit të plotë për fitimin dhe krahasimin me tregun²³, ky fakt i veçuar është i pamjaftueshëm për të arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, ka ekspozuar veten ndaj rrezikut që ajo të bjerë nën ndikimin e palës tjetër në përmbushjen e detyrave të saj publike. Në këtë kontekst, trupi gjykues e vlerësoi si të panevojshëm për zgjidhjen e çështjes hetimin në drejtim të kërkesës së Komisionerit Publik për administrimin e pasqyrave financiare të dy shoqërive [“{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK]. Trupi gjykues çmoi se pasqyrat financiare të dy shoqërive qiramarrëse në të shkuarën, përveç informacionit gjithëpërfshirës apo dhe voluminoz të mënyrës se si funksiononin kompanitë, nuk mund të provonin veprime të subjektit të rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, në kundërshtim me detyrimet e saj profesionale. Për pasojë, përjashtojë mundësia edhe në nivel praktik e qenies së tyre të nevojshme në procesin e rivlerësimit. Si rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi që kontrata e qirasë objekt shqyrtimi në vetvete nuk mund të argumentohet si shkelje e subjektit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 dhe as të jetë relevante në këtë proces.

14.5 Trupi gjykues i Kolegjit po ashtu, vëren se ndryshe nga situata faktike dhe ligjore e konstatuar në vendimin e Kolegjit që i përket subjektit të rivlerësimit Besnik Cani²⁴, kontrata e qirasë së lidhur nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, nuk mund të argumentohet se përbën bashkinvestim me qiramarrësit e ndryshëm ndër vite. Më konkretisht, përpos faktit që te çështja e referuar nga Komisioneri Publik, marrëdhënia juridike e magjistratit përfshinte një subjekt ekonomik të vetëm, marrëdhënia e qirasë në atë çështje ishte parashikuar nga palët të vazhdonte derisa të ishte shlyer investimi, i cili në vijim do të kalonte në pronësi të subjektit të rivlerësimit. Në kontrast me ato rrethana, në rastin e kontratës së qirasë për karburantin në Vlorë, personi i lidhur me subjektin [bashkëshorti] e ka pasur dhe ruajtur në pronësi të tij karburantin me qiramarrës të ndryshëm, me qëllim përfitimin financiar të paracaktuar – siç tregojnë kontratat në vijim me qiramarrësit e mëpasshëm. Për sa më sipër, edhe ky pretendim i Komisionerit Publik u vlerësua i pabazuar nga trupi gjykues i Kolegjit.

01.06.2015, SH. Selimi. dhe K. S. kanë lidhur kontratë noteriale qiraje me qiramarrësin “{***}”, me afat nga data 01.06.2015 deri më 31.05.2020. Sipas kësaj kontrate, qiraja ishte përcaktuar 10.000 euro në muaj.

²² Baza e përlllogaritjes së përqindjeve më sipër, është fitimi neto që rezulton pas zbritjes nga xhiroja mujore e të gjitha shpenzimeve, si kosto e blerjes së karburanteve, tatimeve dhe taksave, pagesave të punëtorëve, shpenzimet korrente, si: energji elektrike, ujë, sigurimi i objektit etj. Kjo kontratë është revokuar me dokumentin revokim kontratë qiraje nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., të datës 25.09.2014.

²³ Gjatë hetimit, Komisioni ka kërkuar informacion nga Administrata Tatimore lidhur me qarkullimin, fitimin apo humbjen e raportuar nga shoqëritë “{***}” ShPK dhe “{***}” ShPK, vetëm për pikën e karburantit që i përket pasurisë në bashkëpronësi të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit. Në përgjigjen e saj [nr. {***} prot., datë 09.10.2020], Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj, përveç vënies në dispozicion të tatimeve të paguara nga njëra nga kompanitë ndër vite, ka shpjeguar edhe që tatimpaguesit deklarojnë dhe paguajnë tatimet për të gjithë veprimtarinë ekonomike që kryejnë, pa e lidhur atë me një adresë specifike.

²⁴ Vendimi nr. 2/2020 (JR), datë 27.02.2020. Shih: <https://kpa.al/wp-content/uploads/2020/07/Vendim-B.-Cani-dhe-mendim-paralel-i-anonimizuar.pdf>.

A.3. Ndërtesa 3-katëshe e ndodhur në fshatin {***}, Fushë-Krujë

15. Komisioneri Publik pretendoi se, duke konsideruar lidhjet e interesit të vjehrrit të subjektit të rivlerësimit, analiza financiare duhej të vlerësonte edhe mundësinë e z. K. S. që të mbulojë investimin për këtë pasuri me të ardhura të ligjshme. Në ankim, Komisioneri Publik parashtroi se Kolegji do të vlerësonte drejt nëse, në vlerësim tërësor të procedurave, ngrihen dyshime në drejtim të interesave të fshehur të subjektit të rivlerësimit apo ndonjë paligjshmërie tjetër në këtë drejtim, që do të mund të ngarkonte me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit dhe të bënte të cenueshëm vendimin e Komisionit, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

15.1 Siç shtjellohet edhe më sipër, Komisioneri Publik kërkoi nga Kolegji cilësimin *person tjetër të lidhur* të vjehrrit të subjektit të rivlerësimit dhe të hetojë bazuar edhe mbi disa elemente, si vijon: (i) subjekti i rivlerësimit ka qenë në përbërjen familjare të bashkëshortit nga shtatori 2003, ndërkohë që ishte emëruar në detyrë në nëntor 2000; (ii) ndërtesa e vetëdeklaruar si e ndërtuar në periudhën 2005-2006, ka shërbyer si burim krijimi i pasurive të krijuara nga subjekti dhe personi i lidhur [shtjelluar edhe më sipër në drejtim të marrëdhënieve të interesit]; (iii) z. K. S. ka blerë pikë shitje karburanti më 16.12.1997, në vlerën 9 milionë lekë në të njëjtën vendndodhje), në vitet 2000 dhe 2005 janë blerë katër (4) pasuri të paluajtshme – tokë bujqësore – në të njëjtën zonë, me sipërfaqe 6700 m² dhe vlerë 180 mijë lekë, ndërsa në vitin 2001 ka blerë apartament në Krujë, në vlerën 1,6 milionë lekë; (iv) në dukje, të ardhurat e z. K. S. janë të pamjaftueshme për të mbuluar vlerën e investimit prej 17.153.760 lekësh – sipas pagesës së ndikimit në infrastrukturë – ndërkohë që dokumentet provuese të dorëzuara nga subjekti, nuk justifikojnë vlerën e investimit; (v) orientimin e Kolegjit që organet e rivlerësimit duhet të hetojnë çdo situatë ku dyshohet se personat e tjerë të lidhur mbajnë pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit; (vi) orientimin e Kolegjit²⁵ për Komisionin që të përmbushë nevojën për cilësimin e saktë ligjor të situatave faktike, në funksion të të provuarit të shkaqeve të përdorura për shkarkimin e subjekteve apo të marrëdhënies së subjekteve me pasuri të caktuara.

15.2 Në parashtrimet e tij në seancë publike, Komisioneri Publik, duke u fokusuar kryesisht te qenia e subjektit të rivlerësimit pjesë e familjes së bashkëshortit, duke filluar nga viti 2003, dhe investimin e konsiderueshëm që përbën kjo pasuri, kërkoi që Kolegji të hetojë përtej proporcionalitetit të diktuar nga marrëdhënia e konfirmuar si person tjetër i lidhur në zbatim të nenit 32, pika 4 e ligjit – shtjelluar nga jurisprudenca e Kolegjit – dhe të vlerësojë mundësinë e z. K. S. për të justifikuar ligjshmërinë e krijimit të pasurive të tij²⁶ në funksion të nenit D të Kushtetutës dhe nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Më tej, në parashtrimet në seancën e datës 19.05.2022, Komisionerja Publike shtoi që rezultatet e këtij hetimi mund të çojnë në një vlerësim në drejtim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016²⁷. Në bisedimet përfundimtare, Komisionerja Publike vlerësoi që mungesa e akteve lidhur me burimet e ligjshme të investimit në ndërtesën objekt analize, nuk afekton në kërkimet e bëra në lidhje me vlerësimin e pasurisë dhe figurës së subjektit.

²⁵ Referuar vendimi nr. 21/2020. Shih faqen 13 të ankimit të Komisionerit: <http://ikp.al/wp-content/uploads/2021/02/48.Ankim-kund%C3%ABr-vendimit-nr.-325-dat%C3%AB-14.12.2020-t%C3%AB-KPK-s%C3%AB-p%C3%ABr-sr-znj.-Rilinda-Selimi.pdf>.

²⁶ Faqe 8 e parashtrimeve të datës 28.04.2022, në: <http://ikp.al/wp-content/uploads/2021/02/Parashtrimet-e-%C3%A7%C3%ABshtjes-dat%C3%AB-28.4.2022.pdf>

²⁷ Faqe 3 e parashtrimeve në seancën e datës 19.05.2022, në: <http://ikp.al/wp-content/uploads/2021/02/Parashtrimet-e-%C3%A7%C3%ABshtjes-dat%C3%AB-19.5.2022.pdf>.

15.3 Në parashtrimet e saj në Kolegj, subjekti i rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, kundërshtoi të gjitha pretendimet e Komisionerit Publik, duke theksuar pikësëpari natyrën individuale të procesit të rivlerësimit, si dhe që hetimi mbi pasuritë e vjehrrit apo kunatit [z. R. S.] përbën një barrë të tepruar, të pajustificuar dhe të paarsyeshme. Në vlerësimin e saj, Komisioneri Publik i ka trajtuar këta dy persona “me të njëjtin standard” si atë të cilit i nënshtrohet ajo si subjekt rivlerësimi. Subjekti theksoi se nuk ka asnjë rrethanë provuese që i bën ata persona tjerë të lidhur me të, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, apo si kontribuues të ndonjë përfitimi të njëanshëm, sipas një marrëdhënieje që rezulton e provuar/e konfirmuar në atë masë [të përfitimit], për të cilën mund të ngarkohet me ligj që të provonte mundësinë e krijimit të pasurive të këtyre individëve me të ardhura të ligjshme. Subjekti po ashtu, shpjegoi se nuk ka qenë asnjëherë pjesë e familjes së vjehrrit, siç rezulton qartë nga fakti që ka ushtruar detyrën e gjyqtarës në gjykata të ndryshme. Vlera e investimit të përlllogaritur në funksion të pagesës administrative të taksës në infrastrukturë, nuk është në fakt vlera reale e pasurisë. Po ashtu, subjekti theksoi që ndërtesa dhe pajisjet janë blerë gjashtë vjet përpara martesës së saj, ndërsa parcelat e tokës dhe apartamenti respektivisht tre dhe dy vjet përpara martesës, sikurse ka pasur edhe pasuri të tjera. Ndërsa gjatë periudhës kur janë kryer punimet në këtë pasuri, subjekti ka qenë në përkujdesje të fëmijëve dhe me leje lindjeje, në dy periudha kohore në vitin 2004 dhe 2005-2006.

15.4 Komisioni konkludoi që vjehri i subjektit të rivlerësimit nuk bën pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, në cilësinë e dhuruesit apo huadhënësit, të parashikuar nga pika 4 e nenit 32 të ligjit nr. 84/2016. Komisioni konstatoi që z. K. S. nuk ka jetuar dhe nuk ka qenë ndonjëherë anëtar i familjes së subjektit të rivlerësimit dhe as ka qenë i përfshirë në të njëjtën certifikatë familjare me të e, për pasojë, kryerja e një analize financiare të mirëfilltë, pa kufizim kohor dhe mbi të gjitha pasuritë, do të ishte e padobishme dhe do të shkonte përtej kompetencave kushtetuese e ligjore të Komisionit, dhe tejkalonte objektin e procesit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, edhe në këndvështrimin procedural, rezultati i arritur nga analiza financiare hipotetike, në çdo rast, nuk do të ishte i përdorshëm dhe legjitim për të ngarkuar me barrë prove apo me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit, edhe nëse do të konstatoheshin problematika apo mangësi lidhur me krijimin, shtesën apo rikonstruktimin e kësaj pasurie.

15.5 Trupi gjykues i Kolegjit, pasi mori në analizë pretendimet e Komisionerit Publik, prapësimet e subjektit të rivlerësimit dhe aktet në fashikull, siç edhe shtjellohet më sipër, vlerësoi se z. K. S. nuk mund të përfshihet në rrethin dhe cilësinë e personit tjetër të lidhur, me arsyetimin e shtjelluar më sipër [shih paragrafin nr. 13 dhe nënpjesët e tij]. Përpos atij arsyetimi, që lidhet kryesisht me pasurinë e shtjelluar në seksionin A.1, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se rrethanat e dokumentuara të krijimit të pasurisë objekt analize, nën dritën dhe brenda kufijve të hetimit që mund të kryhet nga Kolegji në një proces administrativ, tregojnë që krijimi i pasurisë nuk provohet se mund t’i atribuohet subjektit të rivlerësimit apo personit të lidhur e, për pasojë, të shoqërohet me përgjegjësi disiplinore për të. Ky konkluzion është rrjedhojë e analizës, nga njëra anë, e dispozitave të Kushtetutës dhe ligjit që tregojnë qëllimin dhe natyrën e procesit të rivlerësimit – të cilat diktojnë kufijtë e mundshëm të hetimit pasuror në procesin e rivlerësimit – dhe nga ana tjetër, e akteve në fashikull dhe e rrethanave faktike. Në vijim, shtjellohen aspektet mbi të cilat u bazua ky konkluzion.

15.6 Së pari, për sa u përket rrethanave të krijimit të pasurisë, rezulton se z. K. S. ka blerë pasurinë fillestare që ka shërbyer si pikë tregtimi karburanti në vitin 1997. Ndërtesa ekzistuese është pjesë dhe është ndërtuar mbi objektin që ka shërbyer si vend tregtimi karburanti që nga viti

1997²⁸. Konkretisht, nga dokumentacioni i administruar në dosjen e Komisionit, rezulton se z. K. S., si blerësi i vetëm, ka përfituar një sipërfaqe prej 950 m², të ndodhur në fshatin {***} të Fushë Krujës²⁹, kundrejt çmimit prej 9 milionë lekësh. Po ashtu, rezulton se në datën 26.07.2000, z. S. ka blerë edhe katër parcela toke bujqësore. Të gjitha këto transaksione datojnë përpara lidhjes së martesës së subjektit të rivlerësimit me personin e lidhur dhe përpara emërimit të saj në vitin 2001. Në këto kontrata, z. K. S. paraqitet si blerës i vetëm dhe, në emër të tij, janë lëshuar certifikatat e regjistrimit të pasurisë.

15.7 Komisioni ka konstatuar që objekti aktual ka nisur të ndërtohet në vitin 2005. Subjekti i rivlerësimit ka lidhur martesë me bashkëshortin në shtator 2003 dhe ka ushtruar detyrën e gjyqtarës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier nga nëntori 2003 deri në vitin 2011. Këto fakte, si dhe aktet e tjera në fashikull, dokumentojnë jetesën e saj në Vlorë me bashkëshortin³⁰ e, për rrjedhojë, në vlerësim të trupit gjykues të Kolegjit, e bëjnë të pamundur kapërcimin në konceptin e bashkëjetesës në një ekonomi familjare të subjektit me familjen e origjinës së bashkëshortit. Për pasojë, do të ishte e pabazuar në fakte të cilësohej z. K. S. si person tjetër i lidhur me subjektin edhe për këtë pasuri. Nën dritën e këtyre fakteve dhe duke pasur në konsideratë kufijtë mbi të cilët mund të ushtrohet kontrolli mbi pasurinë në procesin e rivlerësimit, pa pasur indicie të besueshme për fshehje pasurie të subjektit dhe personit të lidhur në emër të babait të këtij të fundit në procesin e rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se përfshirja e burimeve të krijimit të kësaj pasurie në kontrollin e kriterit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, do të përbënte tejkalim të tagrave të përcaktuara nga ligji në një proces disiplinor.

15.8 Përpos faktit që z. K. S. nuk përmbush kushtet për t'u cilësuar person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit, edhe për këtë pasuri, trupi gjykues sjell në vëmendje që nga hetimi i kryer nga Komisioni, ka rezultuar *mjaftueshmëri* burimesh, gjendje e cila nuk rezulton të jetë kontestuar në thelb nga Komisioneri Publik gjatë procesit. Komisioneri Publik kërkoi fillimisht hetimin e kësaj pasurie mbi bazën e nenit D të Aneksit të Kushtetutës, nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016³¹ – në funksion të cilësimit të personit tjetër të lidhur – dhe mbi bazën e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, për të argumentuar se rrethana që lidhen me këtë pasuri, vlerësohen si cenim i besimit të publikut nga subjekti i rivlerësimit. Duke i parë në tërësinë e tyre kërkesat e të tria këtyre dispozitave, trupi gjykues thekson se së pari, neni 32, pika 1 e ligjit është dispozitë “mbulesë” që përcakton standardin mbi të cilin vlerësohet pasuria. Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk rezultojnë të kenë deklaruar të drejta pronësie apo përdorimi mbi këtë pasuri, gjë që do të sillte në zbatim nenin 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Së dyti, nuk kanë rezultuar indicie nga aktet në fashikull dhe nga hetimi, që kjo pasuri të jetë në fakt pronë e subjektit dhe e personit të lidhur. Për të njëjtën arsye, do të përbënte kapërcim logjik zbatimin e dispozitës për cenim të besimit të publikut nga subjekti i rivlerësimit, në mungesë të indicieve në këtë proces administrativ për fshehje pasurie.

²⁸ Nga aktet në fashikull, rezulton se në datën 17.09.2009, z. K. S. ka përfituar lejen e legalizimit për ndërtesën 3-katëshe mbi bazën e kërkesës së tij të nëntorit 2006. Sipas kartelës së pasurisë, pasuria ka sipërfaqe 6700 m², nga të cilat ndërtesa 187,81 m² me tre kate, me sipërfaqe totale ndërtimi 624 m².

²⁹ Me kontratën e shitjes me nr. {***} rep., dhe {***} kol, datë 16.12.1997, më palë shitëse M. S., F. S., M. S. dhe M. S..

³⁰ Sipas deklaratave periodike vjetore, si dhe referuar banesës së prenotuar në Vlorë në vitin 2006.

³¹ Neni 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 parashikon: “[...] 1. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive [...]”.

15.9 Për sa më sipër, duke pasur parasysh fillesat e pasurisë, vite përpara se subjekti të lidhte martesë dhe personi i lidhur/bashkëshorti të emërohej gjyqtar, mungesën e aspekteve të lidhjes që do ta bënin z. K. S. person të lidhur në këtë proces dhe kufijtë mbi të cilët do të hetohej pasuria e tij, dhe së fundmi, mungesën e dyshimeve të arsyeshme në këtë proces për pasuri të fshehur të subjektit dhe të personit të lidhur, qoftë edhe në parashtrimet e Komisionerit Publik, trupi gjykues i Kolegjit vendosi të mos hetojë më tej për pasurinë objekt analize dhe e gjeti këtë shkak ankimi të pabazuar.

*A.4. Apartament në {***}, Tiranë*

- 16.** Komisioneri Publik ka kërkuar që gjatë procesit në Kolegj, të saktësohet informacioni në lidhje me një apartament të porositur nga subjekti dhe personi i lidhur në dhjetor 2017, për sa i përket vlerës së kontratave të shitjes që ka aplikuar shoqëria “{***}” ShPK, dhe statusi i kësaj shoqërie kundrejt pasurive të paregjistruara – në kushtet që AShK-ja ka informuar se mungojnë të dhëna për pasuri në emër të kësaj shoqërie. Apartamenti ndodhet në {***}, Tiranë, dhe është deklaruar të ketë sipërfaqe 155 m² dhe verandë 35 m². Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë paguar këstin I prej 40 mijë eurosh. Komisioneri Publik solli në vëmendje edhe një mospërputhje mes sipërfaqes së apartamentit, sipas deklaratës periodike për vitin 2017, krahasuar me kontratën e sipërmarrjes në fashikull për një diferencë prej 30 m² më tepër në këtë të fundit. Po ashtu, Komisioneri Publik ka kërkuar që gjatë hetimit në Kolegj, të administrohet informacion nëse subjekti ka gjykuar çështje me palë ndërgjyqëse vetë ortakun/administratorin e shoqërisë “{***}” ShPK. Së treti, Komisioneri Publik argumentoi që përpos kërimit të informacionit sa më sipër nga vetë Kolegji, trupi gjykues të analizojë aktet në drejtim të rrethanave të tjera që mund të ngarkojnë me përgjegjësi subjektin, nën dritën e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pikat 3 e 5 e ligjit nr. 84/2016. Në bisedimet përfundimtare, siç referohet më sipër, Komisionerja Publike gjeti të shëruar nga debati gjyqësor dhe nga provat e reja të sjella nga subjekti, vetëm çështjen që lidhej me konfliktin e mundshëm të interesit. Problemet e konstatuara lidhur me vlerën e apartamentit dhe sipërfaqen qëndrojnë si janë potencuar në shkaqet e ankimit, vlerësoi Komisionerja Publike.

16.1 Në parashtrimet e saj në Kolegj, subjekti i rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, ka kundërshtuar në tërësi shkaqet e ankimit të ngritura nga Komisioneri Publik, edhe për këtë pasuri. Më konkretisht, subjekti i rivlerësimit theksoi që objekt i hetimit, sipas Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, është saktësia dhe plotësia e deklaratës së pasurisë *vetting*, ndërsa pasuria objekt analize, për shkak të kohës kur është kontraktuar, nuk është pjesë e deklaratës *vetting*. Çmimi i kontraktuar nga palët është më i lartë se vlera mesatare e tregut të lirë për zonën ku ndodhet pasuria, ndërsa çmimi i referuar në kontratën e sipërmarrjes nuk është përfundimtar – subjekti dhe personi i lidhur kanë kryer punime shtesë në apartament sipas marrëveshjes së kryer në janar 2019. Pagesat për punimet e kryera janë shlyer nëpërmjet llogarisë bankare të personit të lidhur. Komisioni e ka pranuar në vendim se çmimi i referencës është më i ulët sesa ai i përlllogaritur fillimisht, gjë që nuk është kontestuar në ankim nga Komisioneri Publik. Problematika me mospërputhjen në sipërfaqen e apartamentit është pasojë e ndërtimit në shkelje të lejes së ndërtimit dhe i atribuohet sipërmarrësit. Gjendja e faktit do të konstatohet vetëm me kontratën e shitblerjes përfundimtare. Së fundmi, nga aktet e përcjella nga gjykatat ku subjekti ka ushtruar detyrën, provohet se administratori i shoqërisë “{***}” ShPK, njëkohësisht ortaku i vetëm i saj, nuk ka qenë palë ndërgjyqëse në çështje të gjykuara prej saj. Në mbështetje të pretendimeve të saj, për këtë shkak

ankimi, subjekti i rivlerësimit paraqiti në Kolegj një sërë aktesh të cilat u pranuan nga Kolegji në cilësinë e provës³². Analiza e tyre është ndërthurur me arsyetimin e trupit gjykues në vijim.

16.2 Për këtë pasuri, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, dhe familja e saj kanë pasur mjaftueshmëri të burimeve financiare të ligjshme, përgjatë vitit 2017: (i) për blerjen e pasurisë së analizuar; (ii) për huadhënien; (iii) për përballimin e shpenzimeve. Gjithashtu ka rezultuar se janë deklaruar saktë të gjitha veprimet financiare të kryera në këtë vit dhe burimet financiare përkatëse.

16.3 Komisioni ka konkluduar se mungojnë elementet e një trajtimi preferencial apo çmimi fiktiv të aplikuar në favor të subjektit të rivlerësimit; çmimi i tregut për zonën është i ngjashëm me çmimin e paguar nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, bazuar në analizën e 7 (shtatë) kontratave të shitblerjes, sjellë nga subjekti i rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi. Kontratat e sjella prej saj në Komision përfshinin apartamente në të njëjtën ndërtesë ose të njëjtën zonë, me palë shitëse të njëjtë si dhe një palë tjetër.

16.4 Së fundmi, Komisioni ka konkluduar se nuk kanë rezultuar vendimmarrje të subjektit në kushtet e konfliktit të interesit në çështje ku palë ishte shoqëria shitëse apo “ortakët/administratorët” e saj. Përpos këtij konkluzioni të dedikuar për shoqërinë sipërmarrëse në kontratën e porosisë së vitit 2017, Komisioni ka konstatuar edhe që nga dokumentacioni i depozituar nga subjekti i rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, nga pesë gjykatat ku ajo ka ushtruar detyrën, dhe nga KLGj-ja, ka rezultuar se ajo nuk ka shqyrtuar në asnjë rast çështje në të cilat ka qenë në ndonjë lidhje interesi³³.

16.5 Në analizë të pretendimeve të Komisionerit Publik, akteve në fashikull dhe argumenteve të parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit arriti në përfundimin që konkluzioni i Komisionit për këtë pasuri është i bazuar. Në kushtet kur subjekti dhe personi i lidhur nuk rezultojnë në mungesë burimesh të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie në vitin 2017, qoftë edhe analizuar në mënyrë të integruar me pasuritë e deklaruara në funksion të procesit të rivlerësimit në janar 2017, problematika e konstatuar në lidhje me mospërputhjet në sipërfaqen e kësaj pasurie, krijuar pas plotësimit të deklaratës *vetting* dhe të paguar pjesërisht, apo problemet në dukje të çmimit të preferencial, për një pasuri të cilën subjekti e ka paguar vetëm pjesërisht pas plotësimit të deklaratës së pasurisë, në kushtet procedurale konkrete përpara të cilave gjendet trupi gjykues i Kolegjit, mbetet përtej tagrave të kontrollit të ushtruar nga institucionet e rivlerësimit. Problematika të tilla do të duhet t’i nënshtrohen, si rregull, kontrollit të institucioneve të tjera të

³² Lidhur me shkakun e ankimit për çmimin e blerjes së apartamenti, subjekti paraqiti: tri kontrata shitjeje, me data respektivisht: 23.11.2021, 08.11.2021 dhe 16.02.2022, dy kontrata sipërmarrjeje që shoqërojnë dy kontratat e para të shitjes, me data respektivisht 06.03.2021 dhe 03.04.2019. Gjithashtu subjekti ka paraqitur edhe leje legalizimi, datë 06.07.2020, të shoqërisë “{***}” ShPK, për legalizimin e godinës ku ndodhet apartamenti i subjektit të rivlerësimit. Për sa i përket pretendimit mbi konflikt të mundshëm interesi me ortakun/administratorin e shoqërisë “{***}” ShPK, subjekti i rivlerësimit ka sjellë pesë (5) shkresa/kthim përgjigjeje nga gjykatat ku ajo ka ushtruar detyrën, e konkretisht: shkresë, datë 01.04.2022, e Gjykatës Administrative të Apelit; shkresë, datë 06.04.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; shkresë, datë 31.03.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier; shkresë, datë 14.04.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan; dhe së fundmi, shkresë, datë 01.04.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Sipas këtyre shkresave, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë gjykuar çështje me administratorin e shoqërisë “{***}” ShPK, z. A. Ç..

³³ Përkatësisht, paragrafët 105, 145 dhe 146 të vendimit të Komisionit.

specializuara shtetërore, të cilat kryejnë kontroll *jokalimtar*. Së fundmi, në kushtet kur subjekti nuk rezulton të ketë gjykuar çështje me palë ndërgjyqëse shoqërinë ndërtuese sipërmarrëse apo ortakun e vetëm/administratorin e saj, nuk rezultojnë dyshime të cilat do të mund të analizoheshin në drejtim të konfliktit të interesit nga vetë subjekti i rivlerësimit.

16.6 Nga aktet në fashikull, rezulton që për këtë pasuri, të deklaruar në deklaratën periodike vjetore për vitin 2017, subjekti dhe personi i lidhur kanë paguar në momentin e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes, dhjetor 2017, vlerën prej 40.000 eurosh, përkundër vlerës totale prej 85 mijë eurosh. Fillimisht, Komisioni ka kërkuar shpjegime³⁴ nga subjekti për shkaqet e aplikimit të një çmimi më të ulët se çmimet e tregut, si dhe të paraqesë kontrata të ngjashme të lidhura nga e njëjta shoqëri ndërtuese me porositës/blerës të ndryshëm, në të njëjtin objekt/zonë dhe me kushte të ngjashme me apartamentin e porositur nga subjekti dhe personi i lidhur. Lidhur me çmimin e tregut të lirë në lekë/m² ndërtim në të njëjtën zonë, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision një shkresë të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (në vijim “AShK”) Tiranë, që mban datën 17.08.2020. Sipas kësaj shkrese, për zonën kadastrale përkatëse, çmimi i referencës³⁵ për apartamente në datën 12.12.2017, ka qenë 66.500 lekë m², vlerë e cila e konvertuar në euro, sipas kursit të Bankës së Shqipërisë në të njëjtën periudhë, rezulton 496 euro m². Më pas, në përgjigje të Komisionit, ASHK-ja³⁶ ka referuar se nuk disponon të dhëna për transaksione që lidhen me apartamente të shitura nga shoqëria “{***}” gjatë vitit 2017 në fshatin {***}.

16.7 Trupi gjykues i Kolegjit pranoi në cilësinë e provës edhe tri (3) kontrata të hartuara pas vendimit objekt shqyrtimi të Komisionit, sjellë nga subjekti i rivlerësimit – referuar më sipër në paragrafin 16.1 dhe në poshtëshënimin nr. 33. Të tria kontratat që datojnë në vitet 2021 dhe 2022, përbëjnë kapërcim kohor të konsiderueshëm, krahasuar me kontratën objekt analize, e cila i përket vitit 2017. Për pasojë, edhe çmimi për metër katror në kontratat e fundme, rezulton në rritje, duke variuar konkretisht nga 600, në 700 euro për m². Përkundër kësaj vlere, trupi gjykues sjell në vëmendje që çmimi për m² në pesë (5) kontratat e sipërmarrjes, referuar nga Komisioni në vendim, e që u përkasin përkatësisht viteve 2015 dhe 2019, është konsiderueshëm më i ulët, konkretisht, 510-550 euro/m². Nga përlllogaritja mbi bazën e kontratës së sipërmarrjes, rezulton që subjekti i rivlerësimit ka rënë dakord të blejë apartamentin me një vlerë dukshëm më të ulët edhe se kontratat shembull që ka sjellë, e konkretisht në vlerën 447³⁷ euro/m². Sipas kësaj llogarie, subjekti i rivlerësimit rezulton të jetë afër fashës së çmimeve që shoqëria e ndërtimit ka aplikuar në periudhën 2015 - 2019, por dukshëm *nën* kufirin më të ulët.

16.8 Argumenti i parashtruar nga subjekti i rivlerësimit dhe i pranuar nga Komisioni, mbështetur në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr. 3, datë 28.12.2016, për Entin Kombëtar të Banesave³⁸, sipas të cilit referohet vlera prej 66.500 lekë/m², ka relevancë të kufizuar në këtë analizë, në kushtet kur subjekti ka kontraktuar me një person juridik *privat* mbi bazën e çmimeve të tregut. Në kontrast me këtë situatë faktike, Udhëzimi i Këshillit të Ministrave, referuar nga ASHK-ja³⁹, në përgjigje

³⁴ Njëpërmjet pyetësorit nr. 7 të datës 28.70.2020.

³⁵ Në bazë të Udhëzimit nr. 3, datë 28.12.2016, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2016”.

³⁶ Me shkresën nr. {***} prot., datë 01.09.2020.

³⁷ Përlllogaritja e përfutur duke marrë në konsideratë sipërfaqen prej 155 m² + 35 m² verandë, kundrejt çmimit total 85.000 euro.

³⁸ <https://ekb.gov.al/wp-content/uploads/2018/01/UKM-Nr.3-date-28.12.2016.pdf>.

³⁹ Shih paragrafin 16.6.

të kërkesës së subjektit, përbën një fashë financiare, përcjellë nga pushteti qendror, një personi juridik publik, për ndërtesat sociale, e me qëllim dhënien e orientimit për të strukturuar shpenzimet nga buxheti i shtetit, dhe në diferencim të shprehur me vlerat mesatare të tregut⁴⁰.

16.9 Në kushtet kur shkaqet e ankimit të ngritura nga Komisioneri kanë për fokus: (i) saktësinë e një deklaratë periodike vjetore që daton pas harkut kohor mbi të cilin kryhet rivlerësimi kalimtar; dhe (ii) qasjen e subjektit të rivlerësimit ndaj ligjit, përfshirë hetimin për konflikt të mundshëm interesi, por jo në çmimin e aplikuar nga sipërmarrësi për subjektin e rivlerësimit për këtë pasuri, trupi gjykues i Kolegjit çmon që sa më sipër, janë jopërcaktuese në zgjidhjen e çështjes. Pa përsëritur sa është shtjelluar më sipër, në këtë konkluzion trupi gjykues mban në konsideratë faktin që nga aktet e administruara në cilësinë e provës, si dhe nga ato në fashikull, subjekti nuk rezulton të ketë marrë vendim në kushtet e lidhjes së interesit me sipërmarrësin në ndonjë cilësi, si dhe faktin që nga analiza financiare, subjekti dhe personi i lidhur kanë rezultuar me burime të ligjshme të mjaftueshme. Të dyja këto aspekte, të cilat mund të lidheshin në parim me momentin kohor objekt rivlerësimi kalimtar, kanë rezultuar pa problematika.

16.10 Së fundmi, Kolegji vëren se as në vendimin e Komisionit, sikurse as në ankimin e Komisionerit Publik, nuk rezulton të jetë arsyetuar përse ka qenë e nevojshme kryerja e analizës financiare për një pasuri për të cilën subjekti ka kryer veprime juridike – kontratë sipërmarrjeje – pas plotësimit të deklaratës së pasurisë *vetting*. Pa përsëritur sa ka konstatuar Kolegji në jurisprudencën e mëparshme⁴¹, kontrolli i të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara në deklaratat e interesave privatë për vitet pas deklarimit *vetting*, kryhet nga ILDKPKI-ja, pasi duke qenë subjekt deklarimi, i nënshtrohet kontrollit të vazhdueshëm për shkak të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”.

16.11 Arsyetimi i mësipërm i Kolegjit gjen zbatim edhe në çështjen konkrete. Konkretisht, trupi gjykues i Kolegjit e gjen me vend të sjellë në vëmendje që analiza e mundësisë së pagesës kundrejt blerjes së apartamentit në Tiranë nga subjekti i rivlerësimit, pas dorëzimit të deklaratës *vetting*, mund të kishte relevancë për procesin e rivlerësimit në rrethana specifike. Konkretisht, nëse një subjekt rivlerësimi do të justifikonte kryerjen e shpenzimeve pas vitit 2016, me të ardhura të padeklaruara apo të pretenduara të akumuluar deri në momentin e dorëzimit të deklaratës *vetting*, do të ishte e arsyeshme analiza nga Komisioni ose Kolegji, në kushtet kur krijohet dyshimi për deklarim të pasaktë dhe të pavërtetë në deklaratën *vetting*. Nga analiza e akteve në fashikull dhe e përmbajtjes së vendimit, nuk rezulton që Komisioni të jetë gjendur në këto kushte apo në rrethana të tjera të cilat të jenë arsyetuar se justifikojnë analizën financiare për periudhën pas deklarimit *vetting*⁴². Për gjithë sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se shkak i ankimit i ngritur nga Komisioneri Publik, përveçse jopërcaktues në vendimmarrje, nuk është i bazuar.

⁴⁰ Shih pikën 4 të udhëzimit nr. 3/2016, referuar më sipër.

⁴¹ Vendimi i Kolegjit që i përket subjektit të rivlerësimit I. Mulkurti [nr. 8/2021 (JR)], datë 09.03.2021, paragrafi 26.3: https://kpa.al/wp-content/uploads/2021/05/Vendimi_Idriz_Mulkurti_-2021.pdf.

⁴² Shih vendimin e sipërcituar.

*A.5 Automjeti në përdorim të subjektit të rivlerësimit, në pronësi të {***}*

17. Komisioneri Publik parashtron në ankim që Komisioni nuk ka mbajtur qëndrim apo hetuar më tej mbi rrethanat që lidhen me një automjet në përdorim të subjektit, deklaruar prej saj në një ndër pyetësorët. Sipas Komisionerit, hetimi duhet të shtrihet në drejtim: (1) të administrimit të kontratave të lidhura nga z. K. S. me shoqërinë “{***}”, për të kontrolluar vlerën e paguar prej tij [z. K. S.], për automjetin [marka “{***}”], si dhe të mundësisë financiare të z. K. S. që me të ardhura të ligjshme të krijojë pasurinë; (2) të burimit të ligjshëm të të ardhurave të vjehrrit të subjektit të rivlerësimit; (3) të hetimit të mundshëm të konfliktit të interesit midis subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “{***}”. Pas administrimit të akteve për një hetim shterues administrativ, Komisioneri Publik parashtron që Kolegji mund të vlerësojë nëse ka rrethana që do të mund të ngarkonin me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit dhe të bënin të cenueshëm vendimin e Komisionit, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

17.1 Trupi gjykues i Kolegjit vëren se në vendimin e Komisionit, nuk ka referencë të kjo pasuri. E njëjta gjë vlen edhe për rezultatet e hetimit administrativ. E vetmja referencë rezulton nga përgjigjet e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ. Sipas këtyre përgjigjeve, subjekti ka deklaruar se e ka përdorur automjetin⁴³ “vetëm për udhëtime të familjes jashtë shtetit, për periudhën 2014 - 2016”. Po aty, subjekti i rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, ka pretenduar se vjehri i saj ka lidhur kontratë me rezervë pronësie më datë 08.01.2013, dhe nuk ka kryer pagesën për vlerën/çmimin e plotë të automjetit. Për pasojë, “{***}” vijonte të kishte të drejtat e pronësisë mbi këtë automjet. Në tetor 2016, “për shkak të mosmarrëveshjeve civile”, shpjegoi subjekti i rivlerësimit, automjeti i është dorëzuar shitësit pronar “{***}”. Në policat e sigurimit, z. K. S. ka vendosur edhe emrin e subjektit të rivlerësimit, sikurse edhe atë të personit të lidhur me të [bashkëshortit] “si përdoruese potenciale e këtij automjeti⁴⁴”.

17.2 Bashkëlidhur parashtrimeve, për të provuar shpjegimet e saj, subjekti i rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, ka paraqitur një kontratë porosie më datë 08.01.2013, ndërmjet palëve “{***}” ShPK, në cilësinë e shitësit dhe z. K. S., në cilësinë e blerësit. Sipas kësaj kontrate, pala shitëse ka përcaktuar çmimin e shitjes së mjetit “{***}”, në vlerën 35.000 euro. Për të siguruar blerjen e mjetit, të dyja palët kanë rënë dakord për kaparin prej 20.000 eurosh.

17.3 Po ashtu, në përgjigje të kërimit të Komisionerit Publik për të hetuar për konflikt të mundshëm interesi, subjekti i rivlerësimit ka sjellë dokumentacioni i cili u administrua nga trupi gjykues i Kolegjit në cilësinë e provës, nga pesë (5) gjykatat ku ka ushtruar detyrën⁴⁵. Sipas këtyre akteve nga gjykatat, nuk rezulton që subjekti të ketë gjykuar çështje me administratorin e shoqërisë “{***}” ShPK, z. H. L.. Në bisedimet përfundimtare, Komisionerja Publike parashtrroi se subjekti i rivlerësimit arriti të provojë se nuk gjendej në kushtet e konfliktit të interesit në lidhje me këtë pasuri.

17.4 Në analizë të pretendimeve të Komisionerit Publik, akteve në fashikull, provave të administruara në procesin gjyqësor dhe pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë ushtruar detyrën në kushtet e

⁴³ Me targë {***}, në pronësi të “{***}”.

⁴⁴ Përgjigjet e subjektit të rivlerësimit për Pyetësorin nr. 1, dërguar nga Komisioni.

⁴⁵ Dokumentacioni i sjellë nga subjekti për këtë aspekt të këtij shkak ankimi përbëhet nga pesë kthime përgjigjesh nga Gjykata Administrative e Apelit, si dhe nga gjykatat e rretheve gjyqësore Fier, Tiranë, Elbasan dhe Vlorë.

konfliktit të interesit me “{***}” apo me administratorin⁴⁶ e kësaj shoqërie. Për pasojë, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, konfirmuar edhe nga Komisionerja Publike, u konfirmuan dhe janë të bazuara.

17.5 Përpos këtij aspekti, siç është arsyetuar më sipër gjerësisht në këtë vendim, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se mungojnë elementet e parashikuara nga ligji për të konsideruar z. K. S. person tjetër të lidhur me subjektin e rivlerësimit. Për pasojë, analiza financiare për të konfirmuar mundësinë e tij financiare që të kryente pagesën e kaparit me të ardhura të ligjshme, nuk ishte e nevojshme në zgjidhjen e çështjes. Duke abstraguuar nga sa më sipër, trupi gjykues konstaton edhe që subjekti i rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, duket kontradiktore në shpjegimin që jep për marrëdhënien e saj me këtë automjet. Konkretisht, ndërsa nga njëra anë, ajo e gjen të nevojshme të shpjegojë përse vjehri i saj ka zbatuar ligjin, duke e mbuluar edhe atë si përdoruese “potenciale” me siguracion ndaj të tretëve [nëpërmjet shtimit të emrit të saj në policën e sigurimit], nga ana tjetër pranon se në fakt *e ka përdorur* realisht automjetin, për udhëtime jashtë vendit, kryesisht. Pavarësisht nga këto mospërputhje, në zbatim të të gjithë arsyetimit të mësipërm, ky shkak ankimi i Komisionerit u gjet jopërcaktues dhe i pabazuar.

A.6. Automjeti BMW në përdorim

- 18.** Komisioneri Publik pretendoi se Komisioni duhej të kishte hetuar për një automjet të markës BMW⁴⁷, të regjistruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (në vijim “DPSHTRr”), që nga polica e sigurimit rezulton në pronësi të kunatit të subjektit të rivlerësimit, dhe të qartësonte në drejtim: (1) të çmimit të blerjes së këtij automjeti; (2) të burimit të ligjshëm të blerjes; (3) të kontratës së shitblerjes dhe palëve në kontratë. Për rrjedhojë, Komisioneri Publik parashtroi nevojën që Kolegji të vlerësojë kryerjen e një hetimi shterues për rrethana që mund të ngarkonin me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit dhe të bënin të cenueshëm vendimin e Komisionit, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Në bisedimet përfundimtare, Komisionerja Publike e grupoi shkakun e ankimit që lidhet me këtë pasuri së bashku me automjetin në përdorim, analizuar më sipër [në seksionin A.4] dhe me argumentet që lidhen me shkaqet e ankimit, për sa u përket burimeve të ligjshme të krijimit të pasurisë në Krujë nga vjehri i subjektit të rivlerësimit [seksioni A.3 më sipër], duke parashtruar që së bashku, këto aspekte afektojnë në drejtim të mosarritjes së nivelit të besueshëm në kontrollin e pasurisë dhe atë të figurës për subjektin e rivlerësimit.

18.1 Komisioni ka hetuar në lidhje me këtë automjet në funksion të kontrollit të figurës. Në konkluzion, Komisioni ka pranuar shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, për mungesë dijenie të faktit që ka qenë e regjistruar si përdoruese e këtij automjeti. Në vijim, Komisioni ka arsyetuar që përdorimi i automjetit nga subjekti duket të ketë qenë “hipotetik” dhe që mungonin prova pozitive që dëshmonin njohjen e subjektit të rivlerësimit me të dy pronarët e automjetit drejtpërdrejt dhe që “[...] rrethanat e konstatuara e lidhin vendosjen e emrit të subjektit në TPL, me aplikimin e këtij opsioni sigurimi në favor të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit [...]”⁴⁸. Në përfundim, siç do të shtjellohet gjerësisht në vijim nën pjesën që u përket shkaqeve të ankimit e lidhen me kriterin e figurës, Komisioni ka konstatuar se qëndronin shpjegimet e subjektit

⁴⁶ Z. H. L. figuron administrator dhe ortak i vetëm i shoqërisë {***}, sipas ekstraktit historik online, të gjeneruar nga faqja zyrtare e Qendrës Kombëtare të Biznesit.

⁴⁷ BMW 535 D”, me targë {***}.

⁴⁸ Paragrafi 131 i vendimit objekt shqyrtimi të Komisionit.

të rivlerësimit. Në vendim nuk ka asnjë referencë të kunati i subjektit të rivlerësimit, lidhur me këtë automjet.

18.2 Në parashtrimet e saj në procesin gjyqësor në Kolegj, subjekti i rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, paraqiti një kontratë shitjeje të këtij automjeti⁴⁹, bashkëngjitur me dokumentacionin shoqërues⁵⁰ që urdhëron zhdoganimin e mjetit dhe regjistrimin e tij. Ndonëse në një policë të sigurimit të vitit 2011, rezulton pronar kunati i subjektit të rivlerësimit, nga dokumentacioni i sjellë prej subjektit të rivlerësimit, rezulton të kenë qenë pronarë dy individë të tjerë në periudhën kohore në fjalë. Polica e sigurimit për përdorimin e mjetit nuk i përket z. R. S. dhe ky i fundit nuk ka pasur asnjë marrëdhënie, qoftë pronësie apo posedimi me këtë mjet. Këto akte u pranuan nga trupi gjykues në cilësinë e provës dhe përmbajtja e tyre është ndërthurur me arsyetimin në vijim.

18.3 Trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi pretendimet e Komisionerit Publik, aktet në fashikull, aktet e administruara në cilësinë e provës dhe dëgjoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit, arriti në përfundimin që pronësia e kunatit të subjektit të rivlerësimit mbeti e paprovuar. Nga hetimi administrativ⁵¹, ka rezultuar se mjeti është i paregjistruar në Republikën e Shqipërisë, ndërsa nga aktet, rezulton një linjë e qartë pronësie si pasojë e kontratave noteriale të shitblerjes dhe dokumentacionit shoqërues të pranuar në cilësinë e provës. Në këto kushte, Kolegji e vlerësoi të panevojshme për zgjidhjen e çështjes dhe të pamundur në këtë procedurë, të hetonte lidhur me çmimin dhe burimin e ligjshëm të blerjes së këtij automjeti.

18.4 Ky konkluzion i trupit gjykues mori në konsideratë edhe të dhënat që rezultojnë nga dokumentacioni në fashikull, përcjellë Komisionit nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (në vijim “AMF”). Në këto akte, autovetura në fjalë [tip BMW, modeli 535D, me targë {***}, prodhim i vitit 2005], rezulton të ketë qenë e siguruar pranë shoqërisë “{***}”, në periudhën kohore në fjalë, 2011 - 2012. Në policën e sigurimit rezultojnë dy pronarë të ndryshëm të automjetit, e konkretisht, z. R. S., kunati i subjektit të rivlerësimit, dhe z. I. Ç.. Nga ana tjetër, nuk rezulton të ketë akte që dëshmojnë përdorimin e këtij automjeti nga subjekti i rivlerësimit, siç ka konstatuar edhe Komisioni. Njësoj ka qenë edhe konstatimi i trupit gjykues të Kolegjit në çështjen që i përket personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit, z. Sh. Selimi. [vendimi i Kolegjit nr. 3/2019 (JR)], për sa i përket pronësisë së këtij automjeti. Konkretisht, në atë vendim të Kolegjit, publikuar në faqen zyrtare⁵², në paragrafin nr. 66, ndër të tjera, është cituar:

[...] Nga analiza e akteve të administruara, trupi gjykues ka konstatuar se ky automjet në datën kur për të kanë prerë policë sigurimi, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja

⁴⁹ Kontratë shitblerjeje me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 01.08.2011. Nga përmbajtja e kontratës, rezulton që z. R. H. i ka shitur automjetin z. I. Ç., për çmimin 120.000 lekë. Nga aktet e sjella nga subjekti, rezulton që z. H. ka blerë automjetin më datë 10.07.2007, nga një shtetas i huaj.

⁵⁰ Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me nr. {***}, datë 24.06.2011, me paditës R. H. dhe të paditur DPSHTRR Vlorë, me objekt detyrimin e të paditurit, Dega e Doganës Vlorë, të bëjë zhdoganimin e automjetit të markës BMW, me targë {***}. Padia është pranuar nga gjykata dhe vendimi ka marrë formë të prerë më datë 21.07.2011.

⁵¹ Nga aktet në fashikull, rezulton që Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (në vijim “DPSHTRR”), në përgjigje të kërkesës së Komisionit për kontratat e shitblerjes së këtij automjeti, si dhe pronarët që rezultojnë gjatë gjithë muajve të vitit 2011, me shkresën e datës datë 22.07.2020 [nr. {***} prot.], ka informuar se mjeti me të dhënat e specifikuara, nuk figuron i regjistruar.

⁵² <https://kpa.al/wp-content/uploads/2018/07/Vendimi-nr.3-date-07.02.2019-subjekti-i-rivleresimit-Shkelzen-Selimi-per-publikim-2.pdf>.

e tij, rezulton të ketë qenë në pronësi të shtetasit R. H.. Ky i fundit, më datë 01.08.2011, ia ka shitur automjetin shtetasit I. Ç. [...].

18.5 Për sa më sipër, rezulton që pretendimi i Komisionerit Publik për pronësi mbi automjetin, nga z. R. S., vëllai i personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit, bazohet mbi një policë sigurimi që gjendet në fashikullin e Komisionit. Në këtë dokument⁵³, në rubrikën me të dhënat e policëmbajtësit, rezulton emri i z. R. S. si pronar dhe emri i subjektit të rivlerësimit si përdorues, ndërsa ditëlindja për të dy individët është shënuar ajo e subjektit të rivlerësimit [01.08.1976], sipas të dhënave të gjendjes civile⁵⁴. Kjo policë është publikuar në datën 21.03.2012, me të njëjtat të dhëna të automjetit dhe për të njëjtën periudhë sigurimi me atë të subjektit të rivlerësimit, por tashmë pronar është vendosur z. I. Ç. dhe targa e mjetit është ndërruar [duke marrë targë nga {***} në {***}].

18.6 Trupi gjykues i Kolegjit vëren se, ndonëse dokumentet e sjella nga subjekti i rivlerësimit në Kolegj, nuk qartësojnë se kujt i përket automjeti, si dhe nga sa rezultoi më sipër, nuk u provua as që z. R. S. ka qenë pronar i këtij mjeti. Në mënyrë që pronari të lejojë përdorimin e mjetit nga të tretë, do të duhej të ishte provuar pronësia mbi këtë mjet, shoqëruar me dokumentacion për një nga mënyrat e fitimit të pronësisë, që në këtë rast nuk rezultojnë të përfshijnë pronësinë e këtij mjeti nga z. R. S. për harkun kohor të marrë në analizë.

18.7 Në kushtet kur gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk rezultuan akte të tjera, përveç policës së sigurimit, dhe as u pretenduan nga Komisioneri Publik akte të tjera, rezulton që përdorimi i mjetit nga subjekti i rivlerësimit të jetë bërë në periudhën kur mjeti ishte në pronësi të z. R. H. edhe të z. I. Ç.. Në këtë linjë, qartësohet edhe fakti që në sistemin e AMF-së, sipas të dhënave të nxjerra nga Komisioni, polica përkatëse është ripërtërirë me pronar blerësin, z. I. Ç.. Për të gjitha arsyet e analizuar më sipër, bazuar në një lexim harmonik të akteve zyrtare, nuk rezultoi e provuar që z. R. S. ka qenë pronar i mjetit. Për pasojë, ky shkak ankimi i Komisionerit Publik është i pabazuar dhe u gjet jopërcaktues në zgjidhjen e çështjes.

B. Lidhur me kriterin e kontrollit të figurës

- 19.** Komisioneri Publik ka parashtruar që nuk qëndron konkluzioni i Komisionit, sipas të cilit subjekti i rivlerësimit ka arritur në nivel të besueshëm të kriterit të figurës, pasi ai nuk bazohet në një vlerësim të drejtë të të gjitha fakteve dhe rrethanave të dala gjatë hetimit administrativ, në një zbatim të drejtë të ligjit nr. 84/2016, si dhe të jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit. Për sa kohë nuk u administrua informacion nga organet ligjzbatuese për kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit, në zbatim të kompetencave kushtetuese dhe në referim të nenit 38, pika 4, Komisioni duhej të analizonte rrethanat ligjore që cilësojnë ekzistencën e një kontakti të papërshtatshëm në kushtet kur, për personin e lidhur të saj, bashkëshortin Sh. Selimi., rezulton i provuar kontakti i papërshtatshëm me persona të përfshirë me krimin e organizuar. Komisioneri Publik çmon se, në rastin konkret, ekzistojnë dy vendime të institucioneve të rivlerësimit, si dhe një gjetje e ONM-së, të cilat përbëjnë rrethana dhe indicie të mjaftueshme që të zhvillohet kontrolli i figurës bazuar në kërkesat e nenit 38 të ligjit nr. 84/2016.

⁵³ *Policë e sigurimit të automjetit nga shoqëria {***}, me nr. serie {***}, lëshuar më datë 27.06.2011, me vlefshmëri njëvjeçare, deri në datën 26.06.2012.*

⁵⁴ *Sipas akteve në fashikull, z. R. S. ka ditëlindje tjetër.*

19.1 Komisioni vendosi të mos administronte materiale të dosjes së procesit të rivlerësimit të kryer lidhur me bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit dhe të kryente hetim të pavarur. Në përfundim, Komisioni arsyetoi se nuk kanë rezultuar informacione dhe fakte që mund të cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, apo të përbëjnë shkak për shkarkimin e saj, në zbatim të pikës 2 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Komisioni i gjeti bindëse shpjegimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me mospërdorimin nga ana e saj të automjetit BMW [analizuar pjesërisht më sipër], pronë e dy individëve që, sipas subjektit të rivlerësimit, përbënin njohje shoqërore të bashkëshortit të saj. Në vlerësimin e Komisionit, u përfshi konstatimi që në momentin kur në emër të subjektit të rivlerësimit, është lëshuar polica e sigurimit për këtë automjet, asnjë nga dy pronarët, z. R. H. dhe z. I. Ç., nuk kualifikohej si kontakt i papërshtatshëm për vepra penale që përfshihen në krimin e organizuar sipas nenit 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016. Së fundmi, Komisioni vlerësoi bindëse shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, se ajo vetë nuk ka pasur kontakt të papërshtatshëm me z. F. D., individ i cili është proceduar penalisht për vepra që përfshihen në krimin e organizuar, duke marrë në konsideratë edhe faktin që në periudhën e ndërmjetme, Prokuroria ka ndryshuar akuzën në “moskallëzim krimi”, nga “trafikim i lëndëve narkotike” dhe gjykata ka marrë vendim përkatësisht.

19.2 Në seancën gjyqësore në Kolegj, subjekti i rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, kundërshtoi pretendimet e Komisionerit Publik si të pabazuara. Rrethanat e hetuara dhe provuara gjatë hetimit, dëshmojnë integritetin e saj të pacenuar. Subjekti e argumentoi qëndrimin e saj në disa aspekte. Së pari, solli në vëmendje që raporti i DSIK-së e ka konstatuar atë të përshtatshme në vijimin e detyrës, mbi bazën e informacionit të organeve ligjzbatuese. Po ashtu, në kushtet kur z. F. D. është dënuar nga gjykata për një veprë penale që nuk përfshihet në gamën e veprave të krimit të organizuar, edhe vendimi për papërshtatshmërinë e figurës së bashkëshortit të saj, është hedhur poshtë me një vendim penal të formës së prerë. Edhe gjetja e ONM-së lidhur me bashkëshortin, e që konfirmoi lidhjen e bashkëshortit me një person të përfshirë në krimin e organizuar, që ka për fokus ndërhyrjen e tij ndaj një gjyqtareje për të parandaluar ekstradimin e një shtetasi shqiptar në Itali, tashmë është provuar të jetë e pabazuar nën dritën e një vendimi të Komisionit që ka marrë formë të prerë dhe ka konfirmuar në detyrë gjyqtaren që refuzoi ekstradimin⁵⁵. Vendimi i Komisionit që ka gjetur të bazuar vendimin e gjyqtares për të mos ekstraduar në Itali z. A.I., akuzuar për vepra penale të krimit të organizuar, dhe lënë atë të lirë, ka marrë formë të prerë – ONM-ja nuk ka ushtruar rekomandim ndaj atij vendimi të Komisionit dhe as Komisioneri Publik nuk ka ushtruar ankim. Tanimë, gjyqtarja është ngritur në detyrë. Së fundmi, subjekti theksoi se është pajisur me Certifikatë Sigurimi Personeli, që është rrjedhojë e një kontrolli rigoroz të figurës të asaj vetë dhe të bashkëshortit⁵⁶. Në mbështetje të parashtrimeve të saj, subjekti i rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, solli dy akte të cilat u administruan nga trupi gjykues i Kolegjit në cilësinë e provës⁵⁷. Analiza e përmbajtjes së tyre është pjesë integrale e arsyetimit në vijim.

⁵⁵ Vendimi nr. 331, datë 11.01.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që lidhet me subjektin e rivlerësimit, znj. I. Hysi: <https://kpk.al/wp-content/uploads/2021/02/Vendim-Igerta-Hysi.pdf>.

⁵⁶ Referuar, ndër të tjera, Vendimit të Këshillit të Ministrave 188/2015.

⁵⁷ Subjekti solli (i) një kopje të certifikatës së sigurisë, lëshuar në emër të saj nga DSIK-ja; dhe (ii) një kopje të vendimit penal nr. 112, datë 07.03.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, nga i cili rezulton që z. F. D. është dënuar për veprën penale të "Moskallëzimit të krimit", të parashikuar nga neni 300 i Kodit Penal dhe dënuar me një vit burg. Në zbatim të nenit 406 të K.Pr.Penale, të pandehurit i është ulur 1/3 e dënimit, duke e dënuar përfundimisht me 8 muaj burgim. Fillimisht, i pandehuri është hetuar nga Prokuroria për veprën penale "Trafikimi i narkotikëve", i kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë, të parashikuar nga neni 283/a, paragrafi i dytë dhe neni 22 i Kodit Penal.

19.3 Në analizë të pretendimeve të Komisionerit Publik, akteve në fashikull, provave të sjella dhe pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit, konkludoi që subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, për shkak se ka kontakte të papërshtatshme të personit të lidhur dhe të asaj vetë, me një person të përfshirë në krimin e organizuar, nën dritën e parashikimeve të nenit Dh pika 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 38 pika 4 e 61 pika 2 të ligjit nr. 84/2016. Pretendimet e Komisionerit Publik janë të bazuara. Konstatimet e pasqyruara në dy vendime të institucioneve të rivlerësimit – vendimi nr. 52/2018 i Komisionit dhe vendimi nr. 3/2019 i Kolegjit të Posaçëm të Apelit – si dhe aktet mbi të cilat ato janë bazuar, konfirmojnë se ka fakte të pakundërshtueshme që cenojnë figurën e subjektit të rivlerësimit dhe përbëjnë shkak për shkarkimin e saj.

19.4 Analiza e rrethanave të faktit në çështjen objekt shqyrtimi, nën dritën e akteve normative që rregullojnë qëllimin dhe parimet e kontrollit të figurës në funksion të procesit të rivlerësimit – konkretisht, neni Dh i Aneksit të Kushtetutës dhe neni 38 i ligjit nr. 84/2016 – passjell konkluzionin e pakontestueshëm që kontakti i papërshtatshëm me persona të përfshirë në krimin e organizuar, gjendet i provuar. Ky fakt është dokumentuar nga pohimet e detajuara të personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ të kryer në procesin e rivlerësimit të tij kalimtar dhe specifikimi i llojit të marrëdhënies shoqërore që përfshinte edhe familjet përkatëse. Fakti që z. F. D. në vitin 2022, është gjetur fajtor për një vepër penale që nuk përfshihet në rrethin e veprave që bëjnë pjesë në krimin e organizuar, sipas përcaktimit të nenit 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016, nuk mund të zhbëjë faktin që procedimi penal për një vepër të përfshirë në këtë rreth veprash – trafikim të lëndëve narkotike në bashkëpunim – ka nisur të paktën nga viti 2013 dhe ka vijuar në ngarkim edhe të tij.

19.5 Së pari, trupi gjykues i Kolegjit vëren se kontakti jorastësor me z. D. është pohuar në mënyrë bindëse dhe pa lënë vend për dyzime nga personi i lidhur, e më pas ka gjetur pasqyrim edhe në vendimin e marrë dhe publikuar në faqen zyrtare në internet të Komisionit. Konkretisht, personi i lidhur me subjektin, pasi u pyet në mënyrë direkte nga Komisioni, për të mbështetur variantin e fakteve të cilave ai u dha prioritet nëpërmjet korrespondencës elektronike me Komisionin, përpos lidhjes mes prindërve respektivë të tij dhe z. D., e karakterizoi lidhjen e tij me këtë individ si miqësi familjare, afatgjatë, të shëndoshë e që, ndër të tjera, përfshinte udhëtime me familjet, festa familjare, përvjetorë:

[...] Siç ju shpjegova, ne kemi hyrje-dalje familjare, të cilën e ruajmë pavarësisht ndryshimit të vendbanimit të familjes sime nga Vlora, prej vitit 2011. Ne takohemi, duke përfshirë: festat familjare, ditëlindjet, përvjetorët, pushime verore, me personin ose edhe familjarisht. Në disa raste, kemi udhëtuar jashtë shtetit të dy, dhe në një rast, me familjet, në Gjermani, në dhjetor të vitit 2013 [...]]⁵⁸.

19.6 Së dyti, mbi bazën e sa më sipër, gjatë ankimit të ushtruar në Kolegj, trupi gjykues ka rikonfirmuar, referuar akteve në fashikull, të njëjtin karakterizim të marrëdhënies miqësore të fortë – jorastësore – afatgjatë dhe familjare, mes personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit dhe të njëjtit individ, z. F. D. duke arsyetuar sa vijon:

⁵⁸ Shih paragrafin 31 të vendimit të Komisionit me nr. 52/2018, që i përket subjektit të rivlerësimit SH. Selimi. – personit të lidhur me subjektin: <https://kpk.al/wp-content/uploads/2018/09/Vendim-Shkelzen-Selimi-i-azhornuar.pdf>.

[...] Gjatë hetimit të zhvilluar nga Komisioni, nëpërmjet analizës së të dhënave të marra nga agjencitë ligjzbatuese, por edhe nga përgjigjet e dhëna nga vetë subjekti, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka një miqësi të gjatë me këtë shtetas dhe familjen e tij. Ai vetë ka pohuar gjatë kthimit të përgjigjeve në pyetësor (me e-mail-in e datës 13.02.2018), se marrëdhënia e tyre është familjare, e shëndoshë dhe afatgjatë, që prej 13 vitesh, kur ai është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë Vlorë. Subjekti e cilëson shembullor këtë shtetas dhe familjen e tij. Ai ka shprehur përgjatë gjithë përgjigjeve të dhëna në Komision, se e vlerëson mënyrën e jetesës së këtij shtetasi dhe familjes së tij, të cilën e ka atashuar pranë të vetes pikërisht për shkak të këtyre arsyeve [...] ⁵⁹.

19.7 Nën dritën e pohimit nën përgjegjësi, të kryer nga personi i lidhur, dhe konstatimeve të bazuara mbi të gjatë hetimit administrativ e në shqyrtimin e ankimit në Kolegj, përshkrimi që u bën marrëdhënieve me këtë individ [z. F. D.] subjekti i rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, duke e karakterizuar vetëm si lidhje shoqërore të bashkëshortit, e cila ka pushuar së ekzistuari me largimin e saj nga Vlora, nuk është bindës pasi pasqyron një përpjekje për të përshkruar faktet në një dritë të favorshme për subjektin në procesin e rivlerësimit. Në të njëjtin kontekst, trupi gjykues i Kolegjit vëren se edhe konkluzioni i Komisionit i cili anashkalon fakte të pakontestueshme, pasqyruar në dy vendimet e sipërcituara të organeve të rivlerësimit për ekzistencën e kontaktit të papërshtatshëm të personit të lidhur – që përfshin edhe vetë subjektin e rivlerësimit – përbën një interpretim të gabuar të fakteve, por edhe një anashkalim të një përcaktimi ligjor të shprehur për ekzistencën e një kontakti të papërshtatshëm në germën “b” të pikës 4 të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016. Kështu, Komisioni, pavarësisht nga sa është pohuar nga personi i lidhur, zgjedh një version të fakteve të ndryshëm: sipas të cilit miqësia e ngushtë është krijuar dhe ka vazhduar “pa përfshirjen e subjektit” apo si “frekuentim midis personave të gjinisë mashkullore” ⁶⁰.

19.8 Sjellim në vëmendje, ndër të tjera, që udhëtimi familjar në Gjermani në dhjetor 2013 – që sipas personit të lidhur ka përfshirë edhe z. D. e familjen e tij, është deklaruar edhe nga vetë subjekti i rivlerësimit ⁶¹, ndonëse në një kontekst tjetër. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit vëren se pretendimet e subjektit për një marrëdhënie që nuk e ka përfshirë atë e, për pasojë, përmbush testin e standardit të komunikimit “rastësor”, janë jobindëse. Për të njëjtën arsye, konkluzioni i Komisionit që bazohet mbi një interpretim arbitrar të fakteve të pakontestueshme, gjendet i gabuar. Subjekti i rivlerësimit vetë dhe/ose nëpërmjet dhe me ndërmjetësinë e personit të lidhur, ka ruajtur komunikim në formën e miqësisë jorastësore me një person të përfshirë në krimin e organizuar, rrethana që provojnë ekzistencën e një kontakti të papërshtatshëm sipas nenit 38, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

19.9 Së dyti, në rrethanat faktike konkrete, trupi gjykues çmon se nuk gjen zbatim asnjë nga rrethanat lehtësuese të parashikuara në pikën 5 të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016. Më poshtë, vijon analiza për tri nga rrethanat lehtësuese të parashikuara nga kjo dispozitë, të cilat paraqesin relevancë në situatën faktike konkrete ⁶².

⁵⁹Vendimi nr. 3/2019 i Kolegjit për subjektin e rivlerësimit SH. Selimi., paragrafi 59: <https://kpa.al/wp-content/uploads/2018/07/Vendimi-nr.3-date-07.02.2019-subjekti-i-rivleresimit-Shkelzen-Selimi-per-publikim-2.pdf>.

⁶⁰ Faqe 35 e vendimit objekt shqyrtimi të Komisionit.

⁶¹ Në pyetësorin nr. 1 të drejtuar nga Komisioni lidhur me udhëtimet familjare jashtë shtetit.

⁶² Germat “b” dhe “ç” parashikojnë përkatësisht rrethana që nuk gjejnë zbatim as teorikisht.

(i) Trupi gjykues i Kolegjit çmon që pretendimi për mungesë dijenie të subjektit të rivlerësimit për zhvillimet e një procedimi penal për trafikim narkotikësh në bashkëpunim, që në vitin 2013 rezultoi edhe me gjykimin e disa të pandehurve, është jobindës. Në kushtet kur disa të pandehur, pjesë e grupit të individëve që përfshinte edhe z. D., të dyshuar si bashkëpunëtorë për veprat penale në fjalë, u hetuan dhe proceduan penalisht, nënkupton logjikshëm që emri i tij, minimalisht me cilësinë e një personi që paraqet interes për organet ligjzbatuese, duhet të jetë shfaqur në dokumentacionin e dosjes gjyqësore përkatëse. Në kushtet e miqësisë së ngushtë që kultivonte personi i lidhur me këtë individ dhe familjen e tij, që nënkupton pjesëmarrje reciproke në ngjarje me rëndësi, stil dhe vlera shoqërore të krahasueshme, duket kontradiktore padijenja e pretenduar nga subjekti, edhe për shkak të formimit personal, për momente me rëndësi në jetën e miqve të familjes. Ky pretendim i subjektit duket si një përpjekje për të provuar një naivitet të skajshëm, që nga ana tjetër bie ndesh me vëmendjen për rrethin shoqëror që mund të kultivojë një funksionare e lartë publike, pa cenuar perceptimin që përcjell në komunitetet të cilat e njohin para së gjithash nëpërmjet detyrës, nëpërmjet këtyre zgjedhjeve shoqërore.

(ii) Në konsideratë të vazhdimësisë së marrëdhënies familjare dhe personale të ngushtë, të përshkruar nga personi i lidhur me subjektin gjatë hetimit administrativ në vitin 2018, rezulton se marrëdhënia e subjektit dhe e personit të lidhur me z. D., plotëson kushtet për t'u kategorizuar e vazhdueshme dhe jo e largët në kohë. Përshkrimi i bërë nga personi i lidhur – sipërcituar në paragrafin 19.5 – referon një marrëdhënie të tashme, aktuale dhe konkrete. Ky përshkrim i kryer në procesin e hetimit administrativ në vitin 2018, pasqyron një marrëdhënie familjare në vazhdimësi të cilën personi i lidhur nuk e ka karakterizuar si të ndërprerë gjatë procesit të shqyrtimit të ankimit në Kolegj përfunduar me vendimin që daton deri në shkurt 2019.

(iii) Në vijim të sa më sipër, nuk gjen zbatim as rrethana lehtësuese e parashikuar në nenin 38, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, pasi nuk rezulton të ketë ndodhur distancim i subjektit nga lidhja me kontaktin e papërshtatshëm pas vitit 2018. Në kushtet kur argumentet prapësuese të subjektit u fokusuan vetëm në përshkrimin e marrëdhënies që ka qenë në përjashtim të saj, në funksion të karakterizimit të situatës në një dritë të favorshme për subjektin, nuk mund të gjejnë mbështetje argumentet për transparencë nga ana e subjektit, sikurse as rrethanat e tjera lehtësuese.

19.10 Së fundmi, trupi gjykues i Kolegjit vëren se pretendimi i subjektit që tenton t'ia atribuojë marrëdhënien me z. D. vetëm bashkëshortit dhe familjes së tij të origjinës⁶³, bie ndesh edhe me faktin që ka rezultuar nga sekuestrimi i automjetit të markës BMW, në përdorim të subjektit të rivlerësimit gjatë viteve 2011 dhe 2012. Pa përsëritur sa është analizuar më sipër, në seksionin A.5, për këtë pasuri, në funksion të kontrollit të pasurisë, automjeti ka qenë në pronësi të dy individëve të ndryshëm teksa ishte në përdorim të subjektit dhe të personit të lidhur. Në 26 nëntor 2011, teksa udhëtonte me të njëjtin automjet [në përdorim të subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur], policia ka arrestuar z. F. D. me një armë zjarri, pa leje. Z. D. është proceduar penalisht për veprën penale të “Mbajtjes pa leje të armëve luftarake e të municioneve”, të parashikuar nga neni 278 i Kodit Penal, dhe përfundimisht është dënuar për këtë vepër penale me vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë në vitin 2012. Automjeti në fjalë u sekuestrua në cilësinë e provës materiale. Fakti që një automjet, në përdorim të subjektit dhe të personit të lidhur, përdorej lirisht nga z. F. D., përforcon bindjen që përshkrimi i bërë nga z. Sh. Selimi. për qëndrueshmërinë e lidhjes me z. F. D., është i saktë dhe pasqyron realitetin, ndërsa pretendimet e subjektit se kjo ishte një miqësi vetëm e bashkëshortit – në kushtet kur automjeti ishte në përdorim familjar, duke përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit – e humbasin kredibilitetin.

⁶³ Sipas shpjegimeve të dhëna nga subjekti gjatë hetimit administrativ.

19.11 Po ashtu, edhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit se bashkëshorti e ka përdorur atë vetëm për *dy javë*⁶⁴, shihen si një përpjekje e mëtejshme për të minimizuar pikëlidhjet me këtë automjet apo për t'i kanalizuar ato kryesisht te personi i lidhur. Së pari, pasi mbulimi me policë sigurimi për dy vjet radhazi, për të dy bashkëshortët, nuk dëshmon nevoja përdorimi episodike dhe as përdorim thjesht personal e rastësor. Përkundrazi, të drejtat dhe nevojat e përdorimit rezultojnë të kenë qenë konstante, pasi kanë vijuar edhe kur automjetit i ndërroi pronësia, në gusht 2011⁶⁵, ndërkohë që automjeti përdorej edhe nga një i tretë – z. D. – pa krijuar nevojën për mbulesë me policë sigurimi.

19.12 Sjellim në vëmendje që pronari i dytë i automjetit, i cili i ka dhënë të drejta përdorimi subjektit [dhe personit të lidhur], z. I. Ç., është një person që ka pasur precedentë penalë në fushën e krimeve kundër jetës dhe është mbajtur nën vëzhgim policor për këtë arsye⁶⁶.

19.13 Siç është referuar përmbledhtazi më sipër, në paragrafin 19.2, subjekti i rivlerësimit parashitroi që, për shkak të zhvillimeve procedurale që kanë ndodhur në periudhën e ndërmjetme nga vendimi i Kolegjit për personin e lidhur, z. D. nuk përbën më person të përfshirë në krimin e organizuar, nën dritën e nenit 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016, pasi është shpallur i pafajshëm për vepra penale që bëjnë pjesë në veprat e krimit të organizuar, meqenëse akuza për të është reduktuar në moskallëzim krimi⁶⁷. Trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje se ky pretendim i subjektit të rivlerësimit, është i pabazuar në përkufizimin e ligjit për këtë koncept, në nenin 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016. Konkretisht, kjo dispozitë parashikon:

[15.] “Person i përfshirë në krimin e organizuar” është çdo person që është dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar, me përjashtim të rastiit kur është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë. Personi konsiderohet i përfshirë në krimin e organizuar edhe kur: a) procedimi penal i filluar ndaj tij pushohet nga organi procedues për shkak të vdekjes, ose sepse nuk mund të merret si i pandehur dhe nuk mund të dënohet; b) deklarohet i pafajshëm nga gjykata pasi vepra penale është kryer nga një person, që nuk mund të akuzohet ose dënohet [...].

19.14 Referuar vendimit të Kolegjit për subjektin e rivlerësimit Sh. Selimi. [personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit], i cili i referohet përgjigjes zyrtare të Prokurorisë së Përgjithshme drejtuar Komisionit, në emër të z. F. D. janë regjistruar tri procedime penale e konkretisht: (i) procedimi penal për “Prodhim dhe shitje të armëve luftarake dhe municioneve”, parashikuar nga neni 278, paragrafi 2 i Kodit Penal; (ii) procedim penal për “Kundërshtim të punonjësit të policisë dhe rendit publik”, parashikuar nga neni 236, paragrafi 1 i Kodit Penal [që nuk iu nënshtroa hetimit]; dhe (iii) për veprën penale “Trafikim i narkotikëve”, kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 283/a, paragrafi i dytë dhe 22 i Kodit Penal, filluar në vitin 2013. Sipas urdhrorit të Prokurorit të Krimeve të Rënda, më datë 19.01.2018, z. D. është marrë si person i dyshuar

⁶⁴ Përgjigjet e Pyetësorit nr. 6 gjatë hetimit administrativ në Komision.

⁶⁵ Shih paragrafin 18.4 dhe poshtëshënimin 59, ndër të tjera.

⁶⁶ Shih edhe paragrafin 68 të vendimit të Kolegjit, që i përket subjektit të rivlerësimit SH. Selimi.

⁶⁷ Përmbledhur në poshtëshënimin nr. 57.

për kryerjen e veprës penale, duke iu regjistruar emri si individ që i atribuohet vepra penale e parashikuar nga nenet 283/a, paragrafi 2 dhe 22 i Kodit Penal [procedimi penal nr. 245, regjistruar më datë 16.11.2013].

19.15 Procedimi i vitit 2013, për të cilin z. D. i është regjistruar emri si person të cilit i atribuohet vepra penale për trafikim narkotikësh në bashkëpunim dhe tentativë, bën pjesë shprehimisht ndër veprat penale të parashikuara nga neni 3, pika 1 e ligjit nr. 10 192/2009, përfshirë në germën “c”. Referuar gjuhës së përcaktuar nga ligji më sipër, rikualifikimi i veprës penale gjatë procesit, pasi është proceduar penalisht për një vepër të krimit të organizuar, nuk parashikohet si një ndër rrethanat që zhbëjnë procedimin penal fillestar për këto vepra dhe as barazohet me pafajësinë. Me fjalë të tjera, fakti që prokuroria ka hetuar për të paktën nëntë (9) vjet për këtë incident të ndodhur në vitin 2013 dhe ka dërguar çështjen në gjyq eventualisht për një vepër penale me rrezikshmëri më të ulët, nuk afekton cilësimin e atij individ si person të përfshirë në krimin e organizuar, për qëllim të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

19.16 Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë nr. {***}, datë 07.03.2022, nuk ka marrë formë të prerë. Nga përmbajtja e vendimit të gjykatës, rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda ka regjistruar procedimin penal nr. {***} kundër pesë të pandehurve, përfshirë edhe z. D., për vepra të ndryshme të parashikuara nga neni 283/a i Kodit Penal – prodhimi dhe trafikimi i lëndëve narkotike. Gjyqtari i seancës paraprake pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, ka vendosur dërgimin e çështjes në gjyq⁶⁸. Gjykata ka marrë vendim dhe dënuar z. D. për moskallëzim krimi, pasi është përballur me kërkesën alternative të prokurorisë për ndryshimin e kualifikimit ligjor në moskallëzim krimi. Më herët, procedimi penal është ndjekur nga Prokuroria për Krimet e Rënda në harkun kohor të viteve 2018 - 2022 ose 2013 - 2022 për disa të pandehur.

19.17 Në përmbledhje të sa më sipër, në kushtet dhe rrethanat konkrete ligjore e faktike, procedimi penal nr. 245/2013, me rezultatet e tij përkatëse për të pandehurit e ndryshëm⁶⁹ dhe ndryshimet e kualifikimeve ligjore përgjatë procedimit nëntëvjeçar, nuk ka kulminuar me deklaram pafajësie me vendim të formës së prerë për z. D.. Z. D. është proceduar penalisht për një vepër të përfshirë në krimin e organizuar, pasi: (i) i është shënuar emri në regjistrin e njoftimeve të veprave penale, në zbatim të nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale; dhe (ii) ka marrë cilësinë e të pandehurit, sipas nenit 34/4 të Kodit të Procedurës Penale. Për pasojë, ai konsiderohet nga ligji si person i përfshirë në krimin e organizuar për efekt të këtij procesi dhe ka marrë edhe cilësinë e të pandehurit – për një vepër të përfshirë në pikën 1 të nenit 3 të ligjit Antimafia [nr. 10 192/2009]. Si i tillë, për shkak të këtij procedimi penal, ai përbën kontakt të papërshtatshëm për subjektin e rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, dhe personin e lidhur me të.

19.18 Subjekti ka argumentuar se pajisja me Certifikatë të Sigurimit të Personelit (CSP) nga DSIK-ja përbën provë që organet ligjzbatuese nuk kanë konstatuar probleme të saj me figurën. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjektet e rivlerësimit të cilët janë certifikuar për t’u mundësuar akses në informacion të klasifikuar për shkak të detyrës, nuk përjashtohen nga kontrolli që kryhet në zbatim të parimeve të nenit 179/b të Kushtetutës, nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës, si dhe

⁶⁸ Me vendimin nr. 66, datë 22.11.2019.

⁶⁹ Ky procedim është analizuar në detaj për pjesë të caktuara të fakteve penale edhe në vendimin e trupit gjykues të Kolegjit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. E. Imeraj [JR 11/2022], paragrafët 37.10 e në vijim: https://kpa.al/wp-content/uploads/2022/06/Vendim_Elizabeta_Imeraj_anonimizuar.pdf.

ligjit nr. 84/2016. Certifikimi nga DSIK-ja, kryer sipas VKM-së nr. 188/2015, kryhet në funksion dhe në dobi të detyrave të përditshme, në të cilat herë pas here mund të përfshihet edhe njohje e administrim informacioni të klasifikuar. Si e tillë, pajisja me certifikatë sigurie nuk nënkupton detyrim për organet e rivlerësimit të kushtëzojnë vendimet e tyre mbi atë bazë. Për të njëjtat arsye, e konkretisht, që lidhen me pavarësinë dhe autonominë në vendimmarrje, trupi gjykues i Kolegjit përdor raportet e organeve ndihmëse, në rastin konkret DSIK-ja, për përshtatshmërinë në funksion të pasjes në konsideratë të të gjithë faktorëve. Në pikën fundore, vendimet e Kolegjit bazohen në legjislacionin e zbatueshëm në fuqi për faktet e provuara gjatë gjykimit. Pavarësia e veprimeve hetimore dhe e vendimmarrjes së organeve të rivlerësimit, sa u takon çështjeve të rivlerësimit kalimtar, është konfirmuar edhe nga Gjykata Kushtetuese me vendimin e saj nr. 2, datë 18.01.2017, gjatë shqyrtimit të pajtueshmërisë së ligjit nr. 84/2016 me Kushtetutën. Për të gjitha këto arsye, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se kriteri i figurës është hetuar dhe konkluduar në mënyrë shteruese nga organet ligjzbatuese dhe nga Komisioni, e nuk mund të përbëjë objekt shqyrtimi të mëtejshëm në Kolegj, është i pabazuar.

C. Vlerësimi i aftësive profesionale

20. Komisioneri Publik pretendoi se disa çështje të lidhura me pagesën e detyrimeve tatimore mbi: (i) qiratë e marra; apo (ii) të ardhurat nga shitja e makinave, janë trajtuar nga Komisioni për qëllime të analizës financiare. Sipas Komisionerit Publik, ka dhe rrethana të tjera që lidhen me çështje etike dhe profesionalizmi, të cilat nuk duhen analizuar vetëm në drejtim të efektit të mospagesës së këtij detyrimi tatimor në rezultatet e analizës financiare, por në drejtim të vlerësimit etiko-profesional të subjektit të rivlerësimit. Po ashtu, Komisioneri Publik argumentoi se ka një vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, në të cilin subjekti është palë paditëse, në të cilin duhej hetuar në drejtim të një trajtimi preferencial e pabarazi ndaj ligjit, fakt që në vlerësimin tërësor, mund të çojë në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut – në referencë të Parimeve të Bangalores për sjelljen e magjistratëve. Së fundmi, në vlerësimin e Komisionerit Publik në ankim, subjekti ka ushtruar detyrën në kushtet e konfliktit të interesit në një çështje ku palë ndërgjyqëse ka qenë një person juridik [{"***"} ShPK] që në momentin e regjistrimit të çështjes pranë Gjykatës Administrative të Apelit, më 05.11.2014, ishte qiramarrës i vjehrit të subjektit të rivlerësimit për pikën e tregtimit të karburantit në Krujë. Në bisedimet përfundimtare, Komisionerja Publike u shpreh se përkundrejt parashtrimeve me shkrim dhe akteve të sjella në cilësinë e provës nga subjekti i rivlerësimit, qëndrojnë vetëm shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe të figurës. Komisionerja Publike argumentoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka ushtruar detyrën në kushtet e konfliktit të interesit, konfirmuar nga aktet e sjella në cilësinë e provës, referuar çështjes me palë ndërgjyqëse [{"***"} ShPK].

20.1 Subjekti i rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, i kundërshtoi të gjitha shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik, si të pabazuara. Në mbështetje të prapësimeve të saj, subjekti solli një akt “Kalim praktike çështje gjyqësore, për çështjen me nr. {***} regjistri themeltar”, të cilit i janë bashkëngjitur gjashtë akte⁷⁰ të tjera, të cilat u administruan nga Kolegji në cilësinë e provës.

⁷⁰ Aktet që përmban praktika, janë kalim praktike çështje gjyqësore, ndarë me shortin e datës 08.04.2016, për çështjen me nr. 8983 regjistri themeltar në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë. Me anë të këtyre akteve, subjekti i rivlerësimit provoi se çështja që i përket shoqërisë {***} ShPK, është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në vitin 2014, ndërkohë që çështjet, të cilat janë regjistruar në këtë vit dhe nuk janë planifikuar për gjykim, janë rishortuar mbi bazën e Urdhrit të Kryetarit të kësaj gjykate, dalë më datë 29.03.2016. Si në shortimin e parë, ashtu edhe në rishortim, subjekti i rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, nuk rezulton të ketë qenë në cilësinë e relatores.

Analiza e tyre është pjesë integrale e arsyetimit të Kolegjit në vijim. Në shpjegimet e saj, subjekti i rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, theksoi sa vijon.

(i) Mbi bazën e nenit 155 të Kushtetutës dhe interpretimit të Gjykatës Kushtetuese të asaj dispozite, rezerva ligjore nënkupton se diferenca që krijohet mes çmimit të shitjes së automjeteve kundrejt atij të blerjes, duke mos qenë e ardhur e listuar shprehimisht në dispozitën që përcakton të ardhurat e tatueshme, nuk i nënshtrohet tatimit e, për pasojë, ajo nuk rezulton të gjendet në një situatë ligjore që nënkupton detyrimin e saj si shitëse për të paguar tatim.

(ii) Shuma prej 2.200 eurosh nga qiraja e apartamentit dhe e garazhit është me burim të ligjshëm, është deklaruar rregullisht dhe detyrimi për të kryer pagesën ishte marrë përsipër nga qiramarrësi dhe u përkiste tre muajve të fundit të qirasë. Për këtë mungesë të tij në pagesë, subjekti është informuar gjatë procesit të hetimit administrativ dhe ka marrë masa që qiramarrësi të shlyente detyrimet. Kërkimi i Komisionerit Publik që këto problematika të vlerësohen në drejtim të aspektit etik dhe profesional dhe besimit të publikut, nuk justifikohet objektivisht. Një shkarkim mbi këto baza, do të ishte joproporcional me qëllimin dhe sjelljen mbi të cilën bazohet.

(iii) Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me palë të paditur “{***}” dhe paditëse subjektin e rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, është publikuar nga {***} për qëllime të paligjshme dhe deniguresh, pasi ka për synim të cenojë garancitë e nenit 8 të KEDNJ-së. Paditës janë pesë (5) palë, jo vetëm subjekti. Dëmi i shkaktuar nga shoqëria ajrore “{***}”, për shkak të refuzimit të udhëtimit, është denigrues, duke qenë se statusi i tyre u njësuua nga i padituri me atë të personave të padëshiruar. Padia u ushtrua për dëm pasuror dhe jopasuror, pasi udhëtarët kishin pasaporta të rregullta, të vlefshme dhe bileta kthyese. Vendimi i shkallës së parë është prishur nga Gjykata e Apelit dhe, për momentin, është në shqyrtim, mbi bazën e rekursit në Gjykatën e Lartë. Pretendimet për trajtim preferencial janë pa bazë dhe të pavërteta. Ende nuk ka një vendim gjyqësor të vlefshëm për këtë çështje. Subjekti i rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, ka ushtruar të drejtën e saj si qytetare për të ushtruar një të drejtë kushtetuese për ankim, ndërsa një vlerësim i veprimeve të saj si subjekt procedural, do të ishte jashtë juridiksionit disiplinor të Kolegjit.

(iv) I pabazuar është edhe shkaku i ankimit të Komisionerit për ushtrim të detyrës në kushtet e konfliktit të interesit. Situatat faktike të cilat lidhen me pagesën e vlerës së qirasë nga “{***}” ShPK, datojnë përpara gjykimit të çështjes më 04.11.2016 dhe përpara se ajo të caktohej gjyqtare e çështjes, pas shortit të datës 08.04.2016. Përpos këtij fakti, pretendimi i Komisionerit se vendimi i dhënë më 04.11.2016, është dhënë në kushtet e konfliktit të interesit, meqenëse deri në maj 2015, paditësi ka kryer pagesat e qirasë, sipas kontratës së revokuar më 16.06.2015, nuk argumenton rastet e parashikuara nga neni 72 i Kodit të Procedurës Civile që rregullojnë detyrimin për dorëheqje të gjyqtarit. Subjekti i rivlerësimit shpjegoi se me shortin e datës 10.11.2014, kjo çështje iu caktua një gjyqtareje tjetër në cilësinë e relatores [gjyqtare A. G.]. Me ardhjen e gjashtë gjyqtarëve të rinj, në datën 21.03.2016, janë rishortuar çështjet e ardhura në gjykatë gjatë vitit 2014 dhe të paplanifikuara për gjykim.

20.2 Komisioni ka vendosur të mos përfshijë të ardhurat për të cilat nuk është shlyer detyrimi financiar në vlerësimin e kontrollit të kriterit pasuror – për çështjen e qirave të apartamentit në Vlorë – duke argumentuar që rrethanat specifike të çmohen në raport me peshën dhe pasojën që mund të passjellë pamjaftueshmëria financiare e mundshme. Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me palë ndërgjyqëse subjektin e rivlerësimit dhe të paditur “{***}”, Komisioni e ka trajtuar në kuadër të parimit të mosndërrhyrjes në themelin e çështjes. Komisioni vlerësoi se mund të ngriheshin dyshime nën këndvështrimin e etikës së subjektit, vetëm nëse do të rezultonin elemente konkrete që do të mund të evidentonin ndonjë përfitim të paligjshëm dhe nëpërmjet një ndikimi të paligjshëm tek organi vendimmarrës. Së fundmi, Komisioni konkludoi se, në kuadër të

detyrimin të subjektit të rivlerësimit, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Civile dhe ligjit nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave”, për sa kohë marrëdhënia e qirasë mes babait të bashkëshortit të subjektit rivlerësimit dhe shoqërive tregtare ka përfunduar shumë kohë përpara pjesëmarrjes së subjektit në trupin gjykues, si dhe për sa kohë nuk u provua se ka gjykuar çështje gjyqësore në kundërshtim me dispozitat ligjore të neneve 72-73 të Kodit të Procedurës Civile, subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë ushtruar detyrën në kushtet e konfliktit të interesit.

20.3 Pasi mori në shqyrtim parashtrimet e Komisionerit Publik, aktet në fashikull dhe provat e administruara, si dhe dëgjoi argumentet e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se argumentet e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, janë të bazuara. Sikurse u konstatua edhe nga Komisionerja Publike në bisedimet përfundimtare, shkaqet e ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit, u provuan nga aktet e sjella prej saj se nuk qëndronin. Mospagimi i detyrimeve tatimore, pas shitjes së automjetit apo atyre që u përkasin të ardhurave nga qiraja – në kushtet kur detyrimet kontraktore kanë qenë të qiramarrësit – nuk mund të argumentohet si gjendje në të cilën subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut. Po ashtu, nga analiza e akteve të fashikull dhe e atyre të sjella në cilësinë e provës, nuk mund të argumentohet që vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që njohu padinë e subjektit dhe i atribuoi një shpërblim pasuror, ka qenë një trajtim i pabarabartë, vetëm mbi bazën e shumës së dëmshpërblimit në favor të paditësve. Së fundmi, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë ushtruar detyrën në kushtet e konfliktit të interesit në momentin kur është marrë vendimi në të cilin palë ndërgjyqëse ishte “{***}” ShPK. Më poshtë, shtjellohet arsyetimi i trupit gjykues mbi secilin aspekt.

20.4 Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë dhënë me qira apartamentin dhe një garazh në Vlorë, për vitet 2011-2013. Gjatë hetimit administrativ, ka rezultuar se, ndonëse të ardhurat nga qiraja janë depozituar në llogarinë e personit të lidhur⁷¹ gjatë vitit 2013, për to nuk rezultojnë të paguara detyrimet tatimore. Sa u përket automjeteve, rezulton se subjekti ka shitur dy automjete, përkatësisht në datën 09.07.2011 dhe 02.08.2012, për të cilat ka pasur diferencë pozitive në shitje, krahasuar me blerjen⁷². Siç u parashtrua përmbledhur më sipër, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar në Kolegji, por edhe gjatë hetimit administrativ se, referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, nuk ka pasur detyrim tatimor. Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se përgjatë periudhës 1-vjeçare që ka pasur në pronësi njërin prej automjeteve, ka kryer investime për përmirësime teknike, për të cilat nuk ka ruajtur dokumentacionin e pagesës.

20.5 Trupi gjykues thekson se mospagimi i tatimit të parashikuar në ligj, për fitimet e realizuara në kuadër të procesit të rivlerësimit, është trajtuar kryesisht në funksion të ligjshmërisë së burimeve për krijimin e pasurive dhe shpenzimeve apo kursimeve, në zbatim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, pikës 19 të nenit 3 dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016⁷³. Në kushtet konkrete, në analizën

⁷¹ Shuma prej 2.200 eurosh në total.

⁷² Përkatësisht, subjekti në vitin 2011, ka shitur kundrejt vlerës 5.000 euro, një automjet të cilin e kishte blerë më datë 01.10.2003, për 250.000 lekë. Po ashtu, në vitin 2012, subjekti ka shitur një automjet kundrejt vlerës 8.000 euro, të cilin e kishte blerë kundrejt çmimit prej 900.000 lekësh, më 26.07.2011.

⁷³ Neni 30 i ligjit nr. 84/2016 parashikon “[...] Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij”. Pika 19 e nenit 3 po aty përcakton që: “[...] “Të ardhura të ligjshme” janë të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur të tij/saj, sipas përcaktimeve të burimit të të ardhurave, të parashikuara në ligjin “Mbi tatimin mbi të ardhurat” [...]”.

financiare të referuar më sipër në këtë arsyetim, trupi gjykues ka përllogaritur të ardhurat sipas këtyre dispozitave, në funksion të mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme në pjesën që i përket kontrollit të pasurisë. Aplikimi i një standardi të dyfishtë, që do të përfshinte edhe kriterin e vlerësimit profesional, në vlerësimin e trupit gjykues, do të ishte penalizues në mënyrë të dyfishtë dhe, për pasojë, joproporcional, edhe në rast se do të ishte në diskutim dhe i përcaktuar qartë nga ligji dhe aktet nënligjore, mospagimi i tatimit. Në këto kushte dhe në përmbledhje, pasi merr në konsideratë edhe pretendimin e subjektit, bazuar në mungesën e detyrimit sipas ligjit nr. 8438/1998, si dhe kushtet kontraktore të kontratës së qirasë për apartamentin në Vlorë, trupi gjykues vëren se asnjë nga këto rrethana, nuk mund të përbëjë shkak që të passjellë masë disiplinore për subjektin e rivlerësimit. Për këto arsye, pretendimi i Komisionerit Publik është i pabazuar.

20.6 Më tej, për sa i përket aspektit që lidhet me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë⁷⁴, me palë ndërgjyqëse subjektin e rivlerësimit, ndër të tjerë dhe “{***}” – rezulton se Komisioni ka hetuar mbi bazën e raportimit në media⁷⁵. Nga hetimi, ka rezultuar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur në favor të paditëses, znj. Rilinda Selimi, duke detyruar të paditurin, “{***}”, të dëmshpërblejë dëmin pasuror e jopasuror në favor të paditësve, në vlerën 30 mijë euro, për shkak të *mospërmbushjes së kontratës së transportit ajror*. Gjykata e Apelit Tiranë [me vendimin nr. {***}], ka vendosur *prishjen* e vendimit nr. {***} të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe *kthimin e çështjes për rigjykim* me një tjetër trup gjykues. Ndaj këtij vendimi, është ushtruar rekurs dhe aktualisht, gjatë shqyrtimit të çështjes së rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, dosja ndodhet në Gjykatën e Lartë⁷⁶.

20.7 Në shpjegimet e dhëna për këtë çështje gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se ky raportim i televizionit {***} është keqinformues dhe abuziv, nga një palë në konflikt të hapur interesi⁷⁷. Subjekti ka sqaruar po ashtu se mosmarrëveshja civile ndërmjet saj dhe tre fëmijëve e mbesës, si palë paditëse, ka të bëjë me refuzimin e udhëtimit të parapaguar për në Milano nga shoqëria ajrore e paditur më datën 27.03.2016, me kthim më datë 02.04.2016. Sipas përfaqësuesit të shoqërisë ajrore, pasaportat e tre fëmijëve të subjektit nuk ishin të vlefshme edhe për një afat tremujor nga dita e nisjes e, për pasojë, nuk u lejuan të udhëtonin.

20.8 Trupi gjykues i Kolegjit vëren se vlerësimi i bazueshmërisë së vendimit objekt analize të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, tejkalon kufijtë e procesit të rivlerësimit për subjektin, znj. Rilinda Selimi. Edhe nëse legjitimimi i palëve në proces do të ishte objekt vlerësimi, pa prekur themelin e çështjes apo në një formë që nuk cenon logjikën e gjyqtarit, kjo analizë nuk mund të kryhet në procesin e rivlerësimit të kriterit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, pasi i atribuohet *një gjyqtareje tjetër* dhe mënyrës se si ajo e ka zgjidhur çështjen. Nga ana tjetër, e drejta për të ngritur ankim për të rivendosur të drejtat e shkelura të pretenduara nga subjektet e

⁷⁴ Me nr. {***}, me palë paditëse znj. Rilinda Selimi etj., dhe me palë të paditur shoqërinë “{***}” s.p.a., me objekt: “Shpërblim dëmi pasuror dhe jopasuror, shkaktuar paditësve për shkak të mosekzekutimit nga i padituri, pa shkak ligjor e në mënyrë të padrejtë, të kontratës së transportit ajror”.

⁷⁵ <http://top-channel.tv/2018/06/11/gjyqtarja-30-mije-euro-demshperblim-se-i-anuluan-viziten-ne-cirkun-kinez/>

⁷⁶ Regjistruar me nr. 1111-03110-002017, me status “studim çështjeje”, linku:

http://gjykataelarte.gov.al/gjl_ceshtje_detaje.php?caseId_sel=201707312&ln=Lng1&uni=20220912161109134059353802367840.

⁷⁷ Subjekti parashtrroi që në kohën e dhënies së kronikës, më 11.06.2018, bashkëshorti i saj SH. Selimi, në atë kohë anëtar i Gjykatës së Lartë, ka qenë pjesë e trupës gjyqësore e cila po shqyrtonte një çështje civile, me palë paditëse V. H., me anën e së cilës ajo kërkonte të fitonte mbi 60% të kuotave në {***}, në rrugë gjyqësore.

rivlerësimit, është e drejtë kushtetuese. Mospërcaktimi i vlerës së dëmit në kërkesëpadi, po ashtu përbën një aspekt i cili është tagër e një gjykate të juridiksionit të zakonshëm, sikurse është rasti aktualisht, nëpërmjet rekursit në Gjykatën e Lartë. Në këto kushte, trupi gjykues nuk e gjen të bazuar të analizojë që vendimi i marrë nga një gjyqtare, provohet të jetë kryer në kushtet e favorizimit të një pale të caktuar, bazuar vetëm në faktin që paditësja është gjyqtare, si dhe që vendimi është prishur në Gjykatën e Apelit për shkaqe procedurale. Për këto arsye, kjo rrethanë po ashtu nuk mund të bëjë shkak për të konstatuar probleme etike të gjyqtares, e cila ka qenë palë paditëse.

20.9 Lidhur me pretendimin në ankim për faktin që subjekti ka qenë pjesë e një trupi gjykues që ka shqyrtuar një padi të “{***}” ShPK, qiramarrës i vjehrrit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se nga aktet në fashikull, rezulton se çështja në fjalë është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë⁷⁸, më datë 05.11.2014. Subjekti i rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, ishte shortuar në cilësinë e anëtares së trupit gjykues. Në këtë periudhë kohore, vazhdonin marrëdhëniet e qirasë të z. K. S. me këtë shoqëri, për pikën e shpërndarjes së karburantit në {***}, Fushë Krujë⁷⁹. Ky fakt konfirmohet edhe nga deklarata e datës 06.06.2015, për revokimin e kontratës së qirasë, datë 19.09.2013, të lidhur ndërmjet shoqërisë “{***}” ShPK dhe z. K. S., vjehrrit të subjektit të rivlerësimit.

20.10 Në përfundim të gjykimit të kësaj çështjeje, në vitin 2016, me cilësinë e kryesueses së trupit gjykues, subjekti i rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, ka dhënë vendimin [nr. {***}, datë 04.11.2016], me anë të të cilit është lënë në fuqi vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila ka rrëzuar padinë e ngritur nga shoqëria “{***}” ShPK. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se, në kushtet kur vendimi është marrë pasi marrëdhënia e qirasë kishte pushuar dhe ndërkohë çështjet e vitit 2014 ishin rishortuar për qëllime të organizimit të brendshëm të gjykatës, në momentin kur subjekti ka marrë vendim, në vitin 2016, marrëdhënia e interesit kishte pushuar së ekzistuari. Në këto kushte, nën dritën e përcaktimeve të nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile, por edhe të dispozitave të ligjit nr. 9367/2005 që kushtëzojnë konfliktin e interesit me vendimmarrje, rezulton që subjekti i rivlerësimit nuk ka marrë vendim në kushtet e konfliktit të interesit.

21. Në përmbledhje të sa është konstatuar më sipër për kriterin e kontrollit të pasurisë, kriterin e figurës, kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, në analizë të problematikave të konstatuara, në një vlerësim të përgjithshëm të tri kriterëve të rivlerësimit dhe pas një vlerësimi tërësor të procedurave sipas parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues i Kolegjit arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit rezultoi me probleme serioze gjatë kontrollit të figurës – shtjelluar në detaj në paragrafin 19 dhe nënpjesët e tij, për shkak të kontaktit të papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar, në kuptim të nenit 38, pika 4, germa “b” e ligjit nr. 84/2016. Kjo rrethanë e bën të pamundur vazhdimin e detyrës.

⁷⁸ Shkresa e Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë nr. {***} prot., datë 13.08.2020, sipas së cilës rezulton se subjekti i rivlerësimit ka marrë pjesë në gjykimin e pesë çështjeve si relatore/anëtare e trupës me shoqëritë “{***}” dhe “{***}” ShPK, nga të cilat katër me të parën dhe një me të dytën.

⁷⁹ Siç konfirmohet dhe nga të dhënat e llogarisë bankare të kumatit të subjektit të rivlerësimit, z. R. S., në të cilën i kanë kaluar qiratë mujore nga kjo shoqëri.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 325, datë 14.12.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, dhe shkarkimin e saj nga detyra.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 22.06.2022, në Tiranë.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATORE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

KRYESUES

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues, jam dakord me vendimin nr. 22, datë 22.06.2022, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me të cilin është vendosur ndryshimi i vendimit nr. 325, datë 14.12.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, por ndryshe nga shumica e trupit gjykues, çmoj se procedura për procesin e rivlerësimit duhet të kishte vazhduar konform ligjit për vlerësimin e kriterit të pasurisë, sipas shkaqeve të ankimit të ngritura nga Komisioneri Publik.
2. Qëndrimi im kundër në këtë çështje, së pari është logjika absurde e përdorur nga shumica, lidhur me interpretimin që ata i bëjnë në rastin konkret personit tjetër të lidhur. Nga aktet në dosjen gjyqësore, konstatoj marrëdhënie interesi pasuror të subjektit të rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, dhe bashkëshortit të saj, me vjehrrin e subjektit z. K. S., duke e klasifikuar kështu, këtë të fundit në cilësinë e *“personit tjetër të lidhur”*, në kuptim të nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, që parashikon se: *“Persona të tjerë të lidhur” janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin ose komisionerin publik që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi.*
3. Lidhja e interesit pasuror dhe e marrëdhënieve të tjera të biznesit rezultojnë të provuara për shkak të rrethanave faktike të evidentuara qartësisht në ankimin e depozituar nga Komisioneri Publik, se z. K. S. është *person tjetër i lidhur* me subjektin e rivlerësimit, për këto arsye: (i) bashkinvestimi në pasurinë objekt analize në vitin 2013; (ii) huaja në shumën 5.140 euro, dhënë nga personi i lidhur [bashkëshorti i subjektit] z. K. S., deklaruar e shlyer në DIPP-në e vitit 2014; (iii) huaja në shumën prej 42.500 eurosh, e dhënë nga personi i lidhur [bashkëshorti i subjektit] z. K. S., e deklaruar në DIPP-në e vitit 2017; (iv) vendosja e apartamentit në Krujë, nga z. K. S. si kolateral për kredinë bankare të përfituar nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur në vitin 2008, (v) fakti që z. K. S. paraqitet në cilësinë e bashkëdebitorit në kontratën e huas së vitit 2013 [me Tirana Bank], marrë për blerje pasurie në bashkëpronësi e vendosur si kolateral për huan; (vi) personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit dhe babai i tij kanë dhënë me qira pasurinë në fjalë dhe të ardhurat e gjeneruara janë depozituar në llogarinë e përbashkët të tyre; (vii) subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar z. K. S. si person të lidhur në deklaratën *vetting* në seksionin përkatës.
Në vlerësimin tim, të gjitha këto marrëdhënie interesi mes subjektit të rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, dhe vjehrrit të saj, z. K. S., e kualifikojnë këtë të fundit automatikisht sipas ligjit, në *person tjetër të lidhur*, fakte që nuk u konsideruan të mjaftueshme për shumicën. Jam kundër logjikës dhe interpretimit të gabuar, të bërë nga shumica e trupit gjykues për këtë rast, duke anashkaluar në këtë mënyrë vlerësimin për kriterin e pasurisë të personit tjetër të lidhur konform dispozitave ligjore, gjë e cila cenon shqyrtimin e çështjes në tërësinë e saj, e bën të paplotë, nuk u jepet përgjigje shkaqeve të ankimit të ushtruar nga Komisioneri Publik, në zbatim të rekomandimit të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit. Shumica e trupit gjykues nuk mund të mohojë marrëdhëniet e interesit mes tyre, të deklaruara në deklaratat periodike dhe deklaratën e pasurisë *vetting*, nga vetë subjekti, të provuara me dokumentacion ligjor, si kontrata etj., të administruara dhe të nënshtruara shqyrtimit në Komision dhe Kolegj. Për të bërë një analizë të plotë në kuadër të rivlerësimit në bazë të ligjit, trupi gjykues duhej të pranonte fillimisht ekzistencën e marrëdhënieve të interesit, duke e kualifikuar z. K. S. person tjetër të lidhur, e më pas të vijonte me verifikimin e ligjshmërisë së pasurisë së tij.

4. Në vijimësi të të njëjtit qëndrim të mbajtur prej meje përgjatë shqyrtimit të çështjeve në Kolegj, në kuadër të procesit të rivlerësimit, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 14 të ligjit nr. 84/2016, çmoj se Kolegji duhej të kishte analizuar mundësinë financiare të z. K. S. për të justifikuar burimin e krijimit të pasurive, të cilat lidhen me subjektin e rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, dhe bashkëshortin e saj, për të qartësuar çdo rrethanë që mund të ngrejë dyshime lidhur me ligjshmërinë e pasurive të subjektit të rivlerësimit. Shpreh dakordësinë me rekomandimin e tre vëzhguesve të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, mbi të cilin është ushtruar dhe ankimi i Komisionerit Publik, për kontrollin e kriterit të pasurisë.
5. Për sa arsyetuar më sipër, çmoj se shumica e trupit gjykues në këtë vendimmarrje, nuk u është përmbajtur kërkesave të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit: *Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive*".
6. Në përfundim, vlerësoj se shumica e trupit gjykues, në zbatim të gabuar të ligjit nr. 84/2016, nuk ka treguar konsistencë në qëndrimin e vet në këtë çështje, e parë në raport me çështje të tjera të shqyrtuara më parë në këtë Kolegj.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Mimoza Tasi, anëtare e trupit gjykues, jam dakord me vendimin nr. 22, datë 22.6.2022, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, me të cilin është vendosur ndryshimi i vendimit nr. 325, datë 14.12.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit, por kam mendim paralel me shumicën e trupit gjykues për sa i përket qëndrimit të mbajtur për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale.

1.1 Trupi gjykues i Kolegjit, në paragrafin 21 të vendimit është shprehur se: *Në përmbledhje të sa është konstatuar më sipër për kriterin e kontrollit të pasurisë, kriterin e figurës, kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, në analizë të problematikave të konstatuara, në një vlerësim të përgjithshëm të tri kritereve të rivlerësimit dhe pas një vlerësimi tërësor të procedurave sipas parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues i Kolegjit arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit rezulton me probleme serioze gjatë kontrollit të figurës – shtjelluar në detaj në paragrafin 19 dhe nënpjesët e tij, për shkak të kontaktit të papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar, në kuptim të nenit 38, pika 4, germa “b” e ligjit nr. 84/2016. Kjo rrethanë, e bën të pamundur vazhdimin e detyrës.*

1.2 Duke votuar si të gjithë anëtarët e trupit gjykues dhe duke qenë dakord me konstatimet për problemet serioze të evidentuara në kontrollin e figurës të subjektit të rivlerësimit, për shkak se u provua me fakte gjatë gjykimit në Kolegj ekzistenca e kontaktit të papërshtatshëm të përfshirë në krimin e organizuar, ndryshe nga anëtarët e tjerë të trupit gjykues, vlerësoj se vendimi duhet të kishte konstatuar papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit edhe në lidhje me kriterin e pasurisë dhe kriterin profesional, për arsyt si më poshtë.

Për kriterin e vlerësimit të pasurisë

2. Komisioneri Publik, në parashtrime, pas njohjes e vlerësimit të akteve të sjella nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e provës për kriterin e pasurisë dhe në bisedimet përfundimtare, u qëndroi shkaqeve që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë, e në mënyrë të posaçme me cilësimin e vjehrrit të subjektit të rivlerësimit si “person tjetër i lidhur”⁸⁰.

Trupi gjykues i Kolegjit, në vendim, për këtë shkak ankimor, ka konkluduar: *Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se në kushtet dhe rrethanat e analizuara më sipër, z. K. S. nuk përbën person tjetër të lidhur sipas përcaktimeve të nenit 32, pika 4. Rrethanat faktike e procedurale të çështjes objekt kontrolli nuk mbështesin zbatimin e përcaktimit të kësaj cilësie mbi bazën e interesave*

⁸⁰ Për këtë shkak ankimor, Komisioneri Publik është shprehur: “Z. K. S. është person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit, nën dritën e përcaktimeve të nenit 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, mbi bazën e lidhjes së interesit”, e cila është krijuar për shkak të shtatë (shtatë) elementeve, e konkretisht: (i) bashkinvestimit në pasurinë objekt analize në vitin 2013; (ii) huaja në shumën 5.140 euro, dhënë nga personi i lidhur [bashkëshorti i subjektit] z. K. S., deklaruar e shlyer në DIPP-në e vitit 2014; (iii) huaja në shumën prej 42.500 eurosh, e dhënë nga personi i lidhur [bashkëshorti i subjektit] z. K. S., e deklaruar në DIPP-në e vitit 2017; (iv) vendosja e apartamentit në Krujë, nga z. K. S. si kolateral për kredinë bankare të përfutur nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur në vitin 2008; (v) fakti që z. K. S. paraqitet në cilësinë e bashkëdeborit në kontratën e huas së vitit 2013 [me Tirana Bank], marrë për blerjen e pasurisë objekt analize. Në këtë kontratë, pasuria në bashkëpronësi u vendos si kolateral për huan; (vi) personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit dhe i ati kanë dhënë me qira pasurinë në fjalë dhe të ardhurat e gjeneruara janë depozituar në llogarinë e tyre të përbashkët; (vii) subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar z. K. S. si person të lidhur në deklaratën “vetting”, në seksionin përkatës”.

pasurorë. Për këtë arsye, ky pretendim i Komisionerit Publik u gjet i pabazuar në ligj dhe në fakte. Të gjendur në kushtet e mungesës së provueshmërisë së dyshimeve për fshehje të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit çmoi se verifikimi i mëtejshëm i pasurive në emër të z. K. S., do të përbënte kapërcim të objektit të procesit të rivlerësimit. Për këto arsye, në vijim edhe të jurisprudencës së sipërcituar në paragrafët 13.7 dhe 13.8, trupi gjykues i Kolegjit, me vendim të ndërmjetëm, konsideroi të panevojshme të hetohet më tej për burimin e krijimit të gjysmës së pasurisë që i përket babait të subjektit të rivlerësimit.

2.1 Ndryshe nga qëndrimi i shumicës, vlerësoj se është i bazuar pretendimi i Komisionerit Publik lidhur me shkaqet ankimore për cilësimin si person tjetër të lidhur të z. K.S. (vjehtërit të subjektit të rivlerësimit), dhe mundësisë së investimit me të ardhura të ligjshme për shumën 101.000 euro, në cilësinë e bashkinvestitorit.

2.2 Neni 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), ka përkufizuar se: “*Persona të tjerë të lidhur*” janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin ose komisionerin publik, që rrjedh nga një **interes pasuror** ose çdo **marrëdhënie tjetër biznesi**. Përkufizimi i mësipërm i “personit tjetër të lidhur” jep një kuptim të zgjeruar të kësaj kategorie personash, duke vendosur në plan të parë interesin pasuror apo çdo marrëdhënie tjetër të kësaj natyre në lidhje me subjektin e rivlerësimit. Në të njëjtën frymë, e shoh edhe përmbajtjen e nenit 32, pika 4 e po këtij ligji, i cili parashikon se: *Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive*. Në interpretimin e zgjeruar që i bëj këtij neni, edhe pse ligjvënësi i ka orientuar dhe konkretizuar marrëdhëniet e interesit pasuror dhe ato të biznesit në drejtim të cilësimit “dhurues”, “huadhënës” e huamarrës”, nuk ka përjashtuar dhe as kufizuar interesat pasurorë e as çdo marrëdhënie tjetër për të cilat personat e tjerë të lidhur janë të detyruar të justifikojnë ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, në kuptim të nenit 3, pika 14 e ligjit.

2.3 Vlerësoj se, për sa kohë nga aktet e depozituara në fashikullin e subjektit të rivlerësimit të ardhur nga Komisioni, si dhe nga provat e administruara në Kolegj, rezulton e provuar që marrëdhëniet e subjektit të rivlerësimit dhe e personit të lidhur (bashkëshortit), me personin e lidhur (vjehtërin), është një marrëdhënie investimi që ka si qëllim krijimin e fitimit dhe të të ardhurave, e konsideroj si një lidhje për interesa pasurorë të mirëfilltë, e për rrjedhojë merr cilësimin e personit tjetër të lidhur dhe, në këtë kuptim, edhe vjehtëri i subjektit të rivlerësimit duhej të justifikonte ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

2.4 Në interpretim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”⁸¹, i ndryshuar dhe të ligjit nr. 9367, datë 4.7.2006, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”⁸², të ndryshuar, që përkufizojnë kuptimin e personit të lidhur me subjektin deklarues, duke u plotësuar ky kuptim me nenin 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, vlerësoj se, në rastin konkret,

⁸¹ Neni 2, pika 4: “‘Person i lidhur me një zyrtar’ ka kuptimin e përcaktuar në legjislacionin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

⁸² Neni 3, pika 11: “‘Person i lidhur me një zyrtar’ është çdo person fizik ose juridik, i cili rezulton të ketë pasur ose të ketë lidhje interesi, pasurore ose vetjake jo pasurore, sipas nenit 5 të këtij ligji, me zyrtarin”.

babai i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit duhej të konsiderohej edhe si person i lidhur⁸³, edhe si person tjetër i lidhur dhe, në të dyja rastet, duhet të justifikonte ligjshmërinë e burimeve dhe të krijimit të pasurisë karburant në Vlorë, pasuri kjo në bashkëpronësi dhe bashkinvestim me subjektin e rivlerësimit.

2.5 Në ndryshim nga shumica e trupit gjykues, e konsideroj bashkinvestimin si një marrëdhënie biznesi që ndërthur interesa të mirëfilltë pasurorë e, në këtë kuptim, në një interpretim të plotë e harmonik të dispozitave të ligjit nr. 84/2016, edhe pse nuk përfshihet në kategorizimin që ka bërë neni 32, pika e tij, vjehri i subjektit të rivlerësimit nuk mund të përjashtohet nga cilësimi si “person tjetër i lidhur”, sipas përkufizimit të bërë në nenin 3, pika 14 e po këtij ligji.

2.6 Nëse do të ishte bërë vlerësimi i të gjitha akteve të ndodhura në dosje dhe fakteve e provave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit gjatë gjykimit të çështjes si në Komision, edhe në Kolegj, duke u konsideruar vjehri si person tjetër i lidhur, vlerësoj se subjekti nuk do të arrinte nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë e, në këto rrethana, në bazë të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, duhej të ishte vlerësuar edhe për këtë kriter si i papërshtatshëm për ushtrimin e detyrës.

Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale

- 3.** Pavarësisht analizës së bërë nga trupi gjykues në vendim, bazuar në ankimin e Komisionerit Publik, parashtrimet dhe bisedimet përfundimtare lidhur me vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, gjykoj se ky kriter duhej të ishte i përfshirë në bazueshmërinë ligjore të vendimit të Kolegjit.

3.1 Komisioneri Publik në ankim ngriti pretendimin e ekzistencës së disa rrethanave që lidhen me çështje të profesionalizmit dhe etikës, sa i përket: (a) mospagesës së detyrimeve tatimore mbi qiratë dhe mbi të ardhurat nga shitja e makinave; (b) trajtimit preferencial të pabarazisë ndaj ligjit (referuar vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, në të cilin subjekti i rivlerësimit është palë paditëse⁸⁴); si dhe (c) ushtrimit të detyrës në kushtet e konfliktit të interesit⁸⁵.

3.2 Në bisedimet përfundimtare, Komisioneri Publik⁸⁶, referuar vlerësimit të bërë për aktet e sjella nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e provës, ndër të tjera, shprehet se u qëndron shkaqeve të ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe kriterin e kontrollit të figurës, ndërsa për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, për shkakun ankimor të ekzistencës së mundshme të gjendjes së konfliktit të interesit në ushtrimin e detyrës, mbajti qëndrimin se subjekti i rivlerësimit, sipas dokumentacionit provues⁸⁷, arriti të provojë se nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

⁸³ Trajtuar në vendimin e Kolegjit, paragrafi 13.14.

⁸⁴ Vendimi me nr. {***}, datë 13.2.2017, me palë paditëse znj. Rilinda Selimi etj., dhe me palë të paditur Shoqërinë “***j.”, me objekt: “Shpërblim dëmi pasuror dhe jopasuror, shkaktuar paditëseve për shkak të mosekzekutimit nga i padituri, pa shkak ligjor e në mënyrë të padrejtë, të kontratës së transportit ajror”.

⁸⁵ Çështje ku palë ndërgjyqëse ka qenë një person juridik “{***}” ShPK, që në momentin e regjistrimit të çështjes pranë Gjykatës Administrative të Apelit, më 05.11.2014, ishte qiramarrës i vjehrit të subjektit të rivlerësimit për pikën e tregtimit të karburantit në Krujë.

⁸⁶ Seanca publike, datë 20.6.2022.

⁸⁷ Parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, faqe 88, lista e akteve shkresore me numër rendor 104.

3.3 Në analizën e bërë në vendimin e Kolegjit për të tria shkaqet ankimore në kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, u gjetën të bazuara argumentet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit⁸⁸.

3.4 Në vlerësimin tim, veçoj se shkaku ankimor që lidhet me trajtim preferencial e pabarazi ndaj ligjit, duhej të ishte trajtuar më thellësisht, duke mbajtur në fokus pasojat që ai sjell në raport me dëmtimin e imazhit dhe cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

3.5 Për shkakun ankimor (b), vendimi i Kolegjit në paragrafin 20.8, është shprehur se: *Trupi gjykues i Kolegjit vëren se vlerësimi i bazueshmërisë së vendimit objekt analize të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, tejkalon kufijtë e procesit të rivlerësimit për subjektin, znj. Rilinda Selimi.*

3.6 Në vlerësimin tim, e gjej të gabuar këtë konkluzion të trupit gjykues të Kolegjit. Konstatoj se vendimi i Kolegjit nuk shkon përtej objektit të rivlerësimit dhe nuk i kalon kufijtë e këtij procesi. Trupi gjykues nuk duhej t'i konsideronte të bazuara argumentet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në parashtrime e konkluzionet përfundimtare.

Konstatimi i shumicës së Kolegjit është i gabuar në lidhje me vlerësimin e kriterit të profesionalizmit për sa i përket mënyrës së trajtimit si nga Kolegji, edhe nga Komisioni të rastit të zhvillimit të gjykimit midis subjektit të rivlerësimit me cilësinë e paditëses (edhe pse padia kishte disa paditës, nga të cilët 3 ishin fëmijët e mitur të subjektit të rivlerësimit dhe një ishte mbesa) dhe shoqërisë “{***}”, me cilësinë e të paditurit.

3.7 Jam dakord me konstatimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Rilinda Selimi, në cilësinë e paditëses, si çdo shtetas, ka të drejtën ligjore të mbrojtjes së interesave të saj pasurorë e jopasurorë nëpërmjet ushtrimit të së drejtës së ngritjes së padisë para një gjykate. Kjo është një e drejtë e sanksionuar me ligj dhe nuk mund t'i mohohet askujt, por gjykoj se mënyra e trajtimit të saj, duke pasur cilësinë e gjyqtarës dhe kohëzgjatja e procesit civil të iniciuar prej saj, ku rezultoi e provuar se në periudhën 4-mujore, shkurt – qershor 2017, u zhvilluan 2 procese gjyqësore në dy shkallë gjykimi, provojnë pa asnjë dyshim një trajtim preferencial nga kolegët gjyqtarë që e vendos subjektin e rivlerësimit në kushtet e ushtrimit të ndikimit të paligjshëm.

3.8 Në ndryshim nga Komisioneri Publik në ankim⁸⁹, pa hyrë në ligjshmërinë e kërkimeve të subjektit të rivlerësimit me cilësinë e paditëses në atë gjykim, element i cili nuk mund të jetë pjesë e procesit të rivlerësimit, vlerësoj se në lidhje me mënyrën e zhvillimit të procesit dhe kohëzgjatjen e tij në aspektin se sa ndikim ka pasur pozicioni dhe statusi i subjektit të rivlerësimit, jemi në kushtet kur konstatohet lehtësisht një trajtim i ndryshëm i subjektit nga shtetasit e tjerë të përfshirë në konflikte civile të ngjashme. Ky trajtim nuk ka asnjë shpjegim tjetër, veç faktit të qenies së paditësit me cilësinë e gjyqtarit dhe ushtrimit të ndikimit për shkak të këtij pozicioni, për zhvillimin sa më shpejt të gjykimit në të cilin ajo ishte pala fituese në shkallë të parë. Këto veprime të subjektit të rivlerësimit i konsideroj në shkelje të hapur të veprimtarisë së saj si gjyqtare, në shkelje të etikës profesionale dhe në tejkallim të parashikimeve të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ku në nenin 4 të tij, “Vlerat themelore”, në pikën 4, parashikohet se: *Magjistrati ushtron funksionet gjyqësore në mënyrë të paanshme, pa ndikim dhe pa paragjykim.*

⁸⁸ Paragrafët 20.1 – 20.10 të vendimit të Kolegjit.

⁸⁹ Ankimi i Komisionerit Publik, paragrafët 25.4 dhe 35.4.1.

3.9 Në ndryshim nga Komisioni në vendim⁹⁰, do të konsideroja “ndikim” nga ana e subjektit të rivlerësimit, shpejtësinë me të cilën u zgjidh kjo mosmarrëveshje civile në këtë gjykatë, në një kohë kur për konflikte të ngjashme, kohëzgjatja e gjykimit mund të shkojë deri në disa vite. Pra, në ndryshim nga vlerësimi i Komisionit, “elementi konkret” që në këtë rast evidentohet dukshëm dhe në mënyrë të provuar, është elementi kohë. Në vlerësimin tim, rezulton e provuar se ushtrimi i ndikimit të subjektit të rivlerësimit për këtë rast, çoi në shkelje e tejkalim të procedurave për zgjidhjen e çështjes brenda një kohe shumë të shkurtër⁹¹, jo vetëm në shkallën e parë të gjykimit, por edhe në shkallën e dytë.

4. Për sa parashtrova më lart, bazuar në vlerësimin tërësor të çështjes, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit, çmoj se jemi para plotësimit të rasteve të shkarkimit të përcaktuara në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016 dhe subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të mjaftueshëm në asnjë nga kriteret e vlerësimit të pasurisë, figurës dhe profesionalizimit dhe, njëkohësisht, me veprimet e saj ka cenuar besimin e publikut te drejtësia.

GJYQTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

⁹⁰ Paragrafi 217 i vendimit të KPK-së.

⁹¹ Vendimi nr. {***}, datë 13.2.2017, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë vendosi pranimin e padisë. Vendimi nr. {***}, datë 29.6.2017, i Gjykatës së Apelit Tiranë vendosi prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kthimin për rigjykim. Ndaj këtij vendimi, është ushtruar rekurs nga subjekti i rivlerësimit në Gjykatën e Lartë.